



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 246

Tiranë – E martë, 12 janar 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 148/2015 datë 21.12.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Singaporit për shërbimet ajrore..... 16813
Ligj nr. 149/2015 datë 21.12.2015	Për ratifikimin e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huas ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës..... 16824
Ligj nr. 150/2015 datë 21.12.2015	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore..... 16825
Ligj nr. 151/2015 datë 21.12.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore..... 16835
Ligj nr. 153/2015 datë 21.12.2015	Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, nënshkruar më 12.7.2006..... 16850



LIGJ
Nr. 148/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SINGAPORIT PËR
SHËRBIMET AJRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Singaporit për shërbimet ajrore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9380, datë 6.1.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SINGAPORIT PËR SHËRBIMET AJRORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Singaporit (më poshtë e quajtur individualisht “Shqipëria” dhe “Singapori”, përkatësisht dhe së bashku “Palët Kontraktuese”);

duke qenë palë në Konventën e Aviacionit Ndërkombëtar Civil të hapur për nënshkrim në Çikago, më 7 dhjetor 1944;

duke njobur rëndësinë e transportit ajror si mjet për krijimin dhe ruajtjen e miqësisë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve të Palëve Kontraktuese;

me dëshirën për të nxitur një sistem ndërkombëtar aviacioni të bazuar mbi konkurrencën ndërmjet linjave ajrore në treg, me ndërhyrje dhe rregullim qeveritar minimal;

me dëshirën për të lehtësuar zgjerimin e mundësive ndërkombëtare të shërbimeve ajrore;

duke pranuar që shërbimet ndërkombëtare ajrore efikase dhe konkurruese forcojnë tregtinë, mirëqenien e konsumatorëve dhe rritjen ekonomike;

me dëshirën për të mundësuar shkallën më të lartë të sigurisë në shërbimet ndërkombëtare ajrore dhe duke rikonfirmuar shqetësimin e tyre themelor në lidhje me aktet dhe kërcënimet kundër sigurisë në avionë, të cilat rrezikojnë sigurinë e personave ose pronës, duke ndikuar negativisht tek operimi i shërbimeve ajrore dhe duke cenuar besimin publik në sigurinë e aviacionit civil;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termi:

a) “Transportim ajror” do të thotë mbartje publike nga avioni i pasagjerëve, bagazheve, mallrave dhe postës, veçmas ose të kombinuara, me shpërblim ose pagesë;

b) “autoritete aeronautike” do të thotë në rastin e Shqipërisë, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, në personin e Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe në rastin e Singaporit, Ministri i Transportit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të Singaporit; ose, në të dy rastet, pasuesit e tyre ose çdo person ose organ tjetër i cili mund të jetë i autorizuar të kryejë çdo funksion që tashmë ushtrohet nga autoritetet e sipërpërmendura ose funksione të ngjashme;

c) “Marrëveshje” do të thotë kjo Marrëveshje, anekset e saj dhe çdo ndryshim i tyre;

d) “shërbimet e rëna dakord” do të thotë shërbimet e planifikuara ndërkombëtare ajrore në itineraret e specifikuar në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje për transportimin e pasagjerëve, bagazheve, mallrave dhe postës, veçmas ose të kombinuara, në pajtim me të drejtat e rëna dakord për kapacitetin;

e) “kapacitet” janë shumatat e shërbimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, zakonisht të matura në numrin e fluturimeve (frekuencat) ose



vendet, tonët e mallrave që ofrohen në një treg (palë qytetesh ose nga vendi në vend) ose në një itinerar gjatë një periudhe të caktuar, si në ditë, javë, sezon ose vit;

f) “Konventë” do të thotë Konventa për Aviacionin Ndërkombëtar Civil, e hapur për nënshkrim në Çikago, më 7 dhjetor 1944, që përfshin çdo aneks të miratuar sipas nenit 90 të asaj Konvente dhe çdo ndryshim i anekseve ose Konventës sipas neneve 90 dhe 94 të saj, në masën që këto anekse ose ndryshime kanë hyrë në fuqi për të dy Palët Kontraktuese;

g) “linjë ajrore e caktuar” do të thotë një linjë ajrore që është caktuar dhe autorizuar për të operuar shërbimet e rëna dakord në pajtim me nenin 4 (Caktimi dhe Autorizimi) i kësaj Marrëveshjeje;

h) “transportim ajror i kombinuar” është mbartja publike nga avioni dhe nga një ose më shumë tipa të transportit rrugor të pasagjerëve, bagazheve, mallrave dhe postës, veçmas ose në kombinim, me shpërblim ose pagesë;

i) “tarifë” është çdo biletë, kuotë ose pagesë për mbartjen e pasagjerëve, bagazheve dhe/ose mallrave (duke përjashtuar postën) në transportimin ajror (duke përfshirë çdo mënyrë tjetër transporti në lidhje me të) që vendoset nga linjat ajrore, duke përfshirë agjentët e tyre dhe kushtet që rregullojnë ofrimin e kësaj bilete, kuote ose pagese;

j) “territor” në lidhje me një shtet, ka kuptimin e caktuar atij në nenin 2 të Konventës;

k) “pagesa të përdoruesit” do të thotë një pagesë ngarkuar linjave ajrore nga autoriteti kompetent ose që lejohet nga ky autoritet për t’u kryer, për ofrimin e pronës ose të pajisjeve në aeroport apo pajisjeve të navigimit ajror, ose pajisjeve ose shërbimeve të sigurisë së aviacionit, duke përfshirë shërbimet dhe pajisjet përkatëse, për avionin, ekuipazhin e tyre, pasagjerët dhe mallrat;

l) “shërbim ajror”, “shërbim ndërkombëtar ajror”, “linjë ajrore” dhe “ndalim jo për qëllime trafiku” kanë kuptimet që u janë dhënë në aneksin 96 të Konventës;

m) “pajisje avioni”, “rezerva” dhe “pjesë këmbimi” kanë kuptimet që u jepen në aneksin 9 të Konventës;

n) “itinerar i specifikuar” do të thotë një itinerar i specifikuar në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

o) të gjitha referencat në fjalët në njëjës interpretohen sikur përfshijnë shumësin dhe të gjitha referencat në fjalët në shumës interpretohen sikur përfshijnë njëjësin, sipas kontekstit.

Neni 2

Dhënia e të drejtave

1. Secila Palë Kontraktuese i jep Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e mëposhtme në lidhje me shërbimet ndërkombëtare ajrore të kryera nga linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese:

a) e drejta për të fluturuar përmes territorit të saj pa u ulur;

b) e drejta për të bërë ndalesa në territor për qëllime jo të trafikut;

c) e drejta për të bërë ndalesa në pikat e itinerarit të specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje për qëllimin e marrjes në bord dhe zbritjes së udhëtarëve, bagazheve, mallrave dhe postës, veçmas ose të kombinuara; dhe

d) të drejtat e shprehura ndryshe në këtë Marrëveshje.

2. Linjat ajrore të çdo Pale Kontraktuese, të ndryshme nga ato të caktuara sipas nenit 3 (Caktimi dhe Autorizimi) të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë edhe të drejtat e specifikuar në paragrafin 1, nënparagrafët “a” dhe “b” të këtij neni.

3. Asgjë në këtë nen nuk konsiderohet t’u japë linjave ajrore të caktuara të secilës Palë Kontraktuese të drejtën për të marrë në bord, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pasagjerë, bagazhe, mallra ose postë, veçmas ose të kombinuara, që mbarten me shpërblim ose pagesë dhe të destinuar për një pikë tjetër në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Të gjitha të drejtat e dhëna në këtë nen nga secila Palë Kontraktuese nuk i jepen ndonjë pale të tretë.

Neni 3

Caktimi dhe autorizimi

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën të caktojë një ose më shumë linja ajrore për qëllimin e operimit të shërbimeve të rëna dakord në itineraret e specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje dhe të tërheqë ose të ndryshojë këto caktime. Këto caktime, tërheqje ose ndryshime të tyre, sipas rastit, i transmetohen me shkrim me kanale diplomatike Palës tjetër Kontraktuese.



2. Me marrjen e një caktimi të tillë dhe të kërkesës nga linja ajrore e caktuar, në formën dhe mënyrën e parashikuar për autorizimin operativ dhe lejen teknike, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese japin autorizimin përkatës operativ dhe lejen teknike me vonesë procedurale minimale, me kusht që:

a) regjistrimi dhe selia e linjës ajrore të caktuar të jetë në territorin e Palës Kontraktuese që cakton linjën ajrore;

b) kontrolli i efektshëm rregullator i linjës ajrore të caktuar ushtrohet dhe mbahet nga Pala Kontraktuese që cakton linjën ajrore;

c) linja ajrore e caktuar është në gjendje të bindë autoritetet aeronautike të Palës Kontraktuese që i jepet caktimi, që ajo është e kualifikuar të përmbushë kushtet e parashikuara sipas ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme për operimin e shërbimeve ndërkombëtare ajrore nga këto autoritete aeronautike në pajtim me Konventën; dhe

d) Pala Kontraktuese që cakton linjën ajrore është në pajtim me nenin 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) dhe nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit) të kësaj Marrëveshjeje.

3. Me marrjen e autorizimit operativ dhe lejes teknike, një linjë ajrore e caktuar mund të fillojë të operojë në çdo kohë shërbimet e rena dakord për të cilat është caktuar, me kusht që linja ajrore të respektojë dispozitat e zbatueshme të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Refuzimi, revokimi, pezullimi dhe kufizimi i autorizimit operativ ose lejes teknike

1. Autoritetet aeronautike të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të refuzojnë, revokojnë, pezullojnë, kufizojnë ose të vendosin kushte për autorizimin operativ ose lejen teknike të një linje ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese, në çdo rast nëse:

a) autoritetet aeronautike të Palës Kontraktuese që i jepet caktimi nuk janë të bindura që regjistrimi dhe selia e linjës ajrore të caktuar janë në territorin e Palës Kontraktuese që cakton linjën ajrore; ose

b) kontrolli i efektshëm rregullator i linjës ajrore të caktuar nuk ushtrohet dhe mbahet nga Pala Kontraktuese që cakton linjën ajrore; ose

c) linja ajrore e caktuar nuk është në gjendje të bindë autoritetet aeronautike të Palës Kontraktuese

që i jepet caktimi, që ajo është e kualifikuar të përmbushë kushtet e parashikuara sipas ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme për operimin e shërbimeve ndërkombëtare ajrore nga këto autoritete aeronautike në pajtim me Konventën; ose

d) Pala Kontraktuese që cakton linjën ajrore nuk është në pajtim me nenin 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) dhe nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit) të kësaj Marrëveshjeje; ose

e) linja ajrore e caktuar nuk operon në pajtim me kushtet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Përveç kur veprimi i menjëhershëm është thelbësor për të parandaluar shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve të parashikuara më sipër ose përveç kur siguria kërkon të ndërmerren veprime në pajtim me dispozitat e nenit 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) ose nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit), të drejtat e renditura në paragrafin 1 të këtij neni ushtrohen vetëm pas konsultimeve ndërmjet autoriteteve aeronautike, në pajtim me nenin 20 (Konsultimet) të kësaj Marrëveshjeje.

3. Ky nen nuk kufizon të drejtat e secilës Palë Kontraktuese për të refuzuar, revokuar, pezulluar, kufizuar ose vendosur kushte mbi autorizimin operues ose lejen teknike të një linje ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese, në pajtim me nenin 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) dhe nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Zbatimi i ligjeve

1. Ligjet dhe rregulloret e secilës Palë Kontraktuese që rregullojnë hyrjen dhe largimin nga territori i vet të avionit të përfshirë në shërbime ndërkombëtare ajrore, ose operimin dhe navigimin e këtij avioni brenda territorit të vet, zbatohen për avionin e linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Ligjet dhe rregulloret e secilës Palë Kontraktuese në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe largimin nga territori i saj të pasagjerëve, ekuipazhit dhe mallrave, duke përfshirë postën, si ato në lidhje me emigrimin, doganat, monedhën, shëndetin dhe karantinën, zbatohen për pasagjerët, ekuipazhin, mallrat dhe postën e mbartur nga avioni i linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, ndërsa ato janë në këtë territor.



3. Asnjë Palë Kontraktuese nuk i jep preferencë një linje ajrore të saj ose tjetër kundrejt një linje ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese të përfshirë në shërbimet ndërkombëtare ajrore të ngjashme, për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të parashikuara në këtë nen.

Neni 6

Transiti i drejtpërdrejtë

Pasagjerët, bagazhet, mallrat dhe posta në transit të drejtpërdrejtë përmes territorit të secilës Palë Kontraktuese dhe që nuk largohen nga zona e aeroportit të rezervuar për këtë qëllim, nuk i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm, përveç se për arsye të sigurisë së aviacionit, kontrollit të lëndëve narkotike, parandalimit të hyrjes ilegale ose në rrethana të veçanta. Bagazhet dhe mallrat në transit të drejtpërdrejtë përjashtohen nga detyrimet doganore dhe taksa të tjera të ngjashme.

Neni 7

Njohja e certifikatave dhe licencave

1. Certifikatat e përshtatshmërisë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe certifikatat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga një Palë Kontraktuese dhe që mbeten në fuqi, njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese për qëllimin e operimit të shërbimeve të rëna dakord, me kusht që kërkesat në të cilat këto certifikata ose licenca janë dhënë ose bërë të vlefshme, të jenë të njëjta ose më të larta se standardet minimale që mund të vendosen në pajtim me Konventën.

2. Nëse privilegjet ose kushtet e licencave ose certifikatave të përmendura në paragrafin 1 më sipër, të lëshuara ose të bëra të vlefshme nga autoritetet aeronautike të një prej Palëve Kontraktuese për një person ose linjë të caktuar ose në lidhje me një avion që përdoret për operimin e shërbimeve të rëna dakord, lejojnë një dallim nga standardet minimale të vendosura sipas Konventës, pavarësisht nëse për këtë dallim është bërë kërkesë në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, Pala tjetër Kontraktuese, pa cenuar të drejtat e Palës Kontraktuese, mund të kërkojë konsultime në pajtim me nenin 20 (Konsultimet) me Palën Kontraktuese me qëllim bindjen që praktika në fjalë është e pranueshme për të.

3. Megjithatë, secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën, që për qëllimet e fluturimit ose uljes në territorin e saj, të refuzojë njohjen e certifikatave të kompetencës dhe licencave të dhëna shtetasve të vet nga Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 8

Siguria teknike e Aviacionit

1. Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë të miratuara nga Pala tjetër Kontraktuese në çdo sferë në lidhje me pajisjet aeronautike, ekuipazhin e fluturimit, avionin ose operimin e avionit. Këto konsultime zhvillohen brenda 30 (tridhjetë) ditë nga kjo kërkesë.

2. Nëse pas këtyre konsultimeve, një Palë Kontraktuese konstaton që Pala tjetër Kontraktuese nuk mban dhe administron me efektivitet standardet e sigurisë në një sferë të tillë që janë të paktën të barabarta me standardet minimale të vendosura në atë kohë në pajtim me Konventën, Pala e parë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese për ato konstatime dhe hapat e çmuar të nevojshëm për të respektuar ato standarde minimale dhe që Pala tjetër Kontraktuese të marrë masa të përshtatshme korrigjuese. Mosmarrja nga Pala tjetër Kontraktuese e masave të përshtatshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ose në një afat më të gjatë, siç mund të jetë rënë dakord, janë shkaqe për zbatimin e nenit 4 (Refuzimi, revokimi, pezullimi dhe kufizimi i autorizimit operativ ose lejes teknike) të kësaj Marrëveshjeje.

3. Pavarësisht detyrimeve të përmendura në nenin 33 të Konventës, është rënë dakord që çdo avion i operuar ose në marrëdhënie qiraje në emër të linjës ose linjave ajrore të një prej Palëve Kontraktuese për shërbimet në ose nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, ndërsa ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, mund t'i nënshtrohet një shqyrtimi nga përfaqësuesit e autorizuar të Palës tjetër Kontraktuese në bord dhe rreth avionit për të verifikuar vlefshmërinë e dokumenteve të avionit dhe ato të ekuipazhit të fluturimit dhe gjendjen e dukshme të avionit dhe pajisjeve të tij (në këtë nen quhet “inspektimi rampe”), me kusht që kjo të mos çojë në vonesë të paarsyeshme.



4. Nëse një inspektim rampe ose një sërë inspektimesh rampe nxjerrin shqetësime serioze, që:

a) një avion ose operimi i një avioni nuk respekton standardet minimale të vendosura në atë kohë, në pajtim me Konventën; ose

b) ka mungesë ruajtjeje dhe administrimi me efektivitet të standardeve të sigurisë në atë kohë, në pajtim me Konventën,

Pala Kontraktuese që kryen inspektimin rampe, për qëllimet e nenit 33 të Konventës, është e lirë të nxjerrë përfundimin që kërkesat sipas të cilave është dhënë ose bërë e vlefshme certifikata ose licencat në lidhje me atë avion ose ekuipazhin e fluturimit ose që kërkesat në të cilat operohet ai avion nuk janë të njëjta ose më të larta se standardet minimale të vendosura në pajtim me Konventën.

5. Në rast se refuzohet hyrja për qëllimin e kryerjes së një inspektimi rampe në një avion të operuar nga ose në emër të linjës ajrore ose linjave ajrore të një Pale Kontraktuese në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni nga përfaqësuesi i asaj linje ajrore ose linjave ajrore, Pala tjetër Kontraktuese është e lirë të nxjerrë përfundimin që ka shqetësime serioze të tipit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni dhe të nxjerrë përfundimet e përmendura në atë paragraf.

6. Secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose ndryshojë menjëherë autorizimin operativ të një ose disa linjave ajrore të Palës tjetër Kontraktuese në rastin kur Pala e parë Kontraktuese nxjerr përfundimin që, qoftë si rezultat i një inspektimi rampe apo një sërë inspektimesh rampe, një refuzimi të një inspektimi rampe, konsultimeve apo tjetër, masat e menjëhershme janë thelbësore për sigurinë e operimit të një linje ajrore.

7. Çdo masë e një Pale Kontraktuese, në pajtim me paragrafin 2 ose paragrafin 6 të këtij neni, ndërpritet nëse nuk vazhdon të ekzistojë shkaku për marrjen e asaj mase.

Neni 9

Siguria fizike e Aviacionit

1. Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë në çdo kohë konsultime në lidhje me standardet e sigurisë të miratuara nga Pala tjetër Kontraktuese në çdo fushë në lidhje me pajisjet aeronautike, ekuipazhin, avionin ose operimin e avionit. Këto

konsultime zhvillohen brenda tridhjetë (30) ditëve nga kjo kërkesë.

2. Në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, Palët Kontraktuese riafirmojnë që detyrimi i tyre kundrejt njëra-tjetrës për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj veprimeve të ndërhyrjes së paligjshme përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Pa cenuar përgjithësinë e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, Palët Kontraktuese, veprojnë veçanërisht në pajtim me dispozitat e Konventës për Veprat Penale dhe Veprimet të Tjera të Caktuara të Kryera në Bordin e Avionit, të nënshkruar në Tokio, më 14 shtator 1963, Konventës për Shtypjen e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionit, të nënshkruar në Hagë, më 16 dhjetor 1970, Konventës për Shtypjen e Veprimeve të Paligjshme kundër Sigurisë në Aviacionin Civil, të nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971, Protokollin e tij Shtesë për Shtypjen e Veprimeve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i Ofrojnë Shërbime Aviacionit Ndërkombëtar Civil, të nënshkruar në Montreal, më 24 shkurt 1988, Konventës për Shënjimimin e Lëndëve Eksplozive Plastike për Qëllimin e Zbulimit, të nënshkruar në Montreal, më 1 mars 1991, dhe çdo konvente dhe protokoll tjetër të lidhje me sigurinë e aviacionit civil ku aderojnë të dy Palët Kontraktuese.

3. Palët Kontraktuese, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës të gjithë ndihmën praktike për të parandaluar veprimet e kapjes së paligjshme të aviacionit civil dhe veprime të tjera të paligjshme kundër sigurisë së këtij avioni, pasagjerëve dhe ekuipazheve të tyre, aeroportëve dhe pajisjeve të navigimit ajror, dhe çdo kërcënim tjetër për sigurinë e aviacionit civil.

4. Palët Kontraktuese, në marrëdhëniet e tyre reciproke, veprojnë në pajtim me dispozitat për sigurinë e aviacionit të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil dhe të caktuara si anekse të Konventës, në masën që këto dispozita të sigurisë janë të zbatueshme për Palët Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese kërkon që operatorët e avionit të vendit të regjistrimit ose operatorët e avionit që kanë selinë e aktivitetit ose vendbanimin e përhershëm në territorin e saj dhe operatorët e aeroportit në territorin e saj, të veprojnë në pajtim me këto dispozita për sigurinë e aviacionit.



5. Secila Palë Kontraktuese bie dakord që këtyre operatorëve të avionit t'u kërkohet të respektojnë dispozitat e sigurisë së aviacionit të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Palën tjetër Kontraktuese që kërkohen për hyrjen, largimin ose gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese garanton që të zbatohen masa të përshtatshme me efektivitet brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, bagazhin e dorës, bagazhin, mallrat dhe rezervat e avionit para dhe gjatë embarkimit ose ngarkimit. Secila Palë Kontraktuese vepron gjithashtu e gatshme, me kërkesën e Palës tjetër Kontraktuese, për masat e arsyeshme dhe të veçanta të sigurisë për të përballuar një kërcënim të veçantë.

6. Nëse ndodh një incident ose kërcënim i një incidenti për kapjen e paligjshme të avionit civil ose një veprimi tjetër të paligjshëm ndaj sigurisë së këtij avioni, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, aeroporteve ose pajisjeve të navigimit ajror, Palët Kontraktuese asistojnë njëra-tjetrën duke lehtësuar komunikimin dhe masat e tjera të përshtatshme që synojnë ndërprerjen e shpejtë dhe të sigurt të këtij incidenti ose kërcënimi të tillë, në masën që është praktike sipas rrethanave.

7. Nëse një Palë Kontraktuese ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që Pala tjetër Kontraktuese u është shmangur dispozitave të këtij neni, autoritetet aeronautike të Palës së parë Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime të menjëhershme me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e kësaj kërkesë përbën shkak për zbatimin e nenit 4 (Refuzimi, revokimi, pezullimi dhe kufizimi i autorizimit operativ ose lejes teknike) të kësaj Marrëveshjeje. Nëse kërkohet nga një emergjencë, ose për të shmangur mospërputhjen e mëtejshme me dispozitat e këtij neni, një Palë Kontraktuese mund të marrë veprim të ndërmjetëm sipas nenit 4 (Refuzimi, revokimi, pezullimi dhe kufizimi i autorizimit operativ ose lejes teknike) të kësaj Marrëveshjeje para kalimit të 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Çdo veprim i ndërmarrë në pajtim me këtë paragraf ndërpritet, nëse Pala tjetër Kontraktuese respekton dispozitat e sigurisë të këtij neni.

Neni 10

Tarifat e përdoruesit

1. Asnjë Palë Kontraktuese nuk vendos ose lejon vendosjen e tarifave të përdoruesit për linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, më të larta se ato që u vendosen linjave ajrore të veta të cilat operojnë shërbime ndërkombëtare të ngjashme ajrore.

2. Secila Palë Kontraktuese inkurajon konsultimet për tarifat e përdoruesit ndërmjet autoriteteve të veta kompetente për tarifat dhe linjave ajrore që përdorin shërbimet dhe pajisjet e dhëna nga këto autoritete që vendosin tarifën, dhe sipas rastit, nëpërmjet organizatave përfaqësuese të këtyre linjave ajrore. Këtyre përdoruesve u bëhet njoftim i arsyeshëm për çdo propozim në lidhje me ndryshimet në tarifat e përdoruesit për t'u dhënë mundësi të shprehin mendimet e tyre para se të bëhen ndryshimet. Çdo Palë Kontraktuese inkurajon më tej autoritetet e saj kompetente për tarifat dhe ata përdorues për të shkëmbyer informacionin përkatës në lidhje me tarifat e përdoruesit.

Neni 11

Detyrimet doganore

1. Mbi bazën e reciprocitetit dhe në masën më të gjerë të mundshme, secila Palë Kontraktuese e përjashton një linjë ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese, sipas ligjeve, rregullave dhe rregulloreve të veta të brendshme, nga detyrimet doganore, akciza, tarifat e inspektimit dhe detyrime dhe pagesa të tjera të brendshme mbi avionët, karburantin, pajisjet tokësore, vajrat lubrifikantë, furnizimet teknike të konsumit, pjesët e këmbimit, duke përfshirë motorët, pajisjet e zakonshme të avionëve, rezervat e avionit, përfshirë ushqimin, pijet, likeret dhe duhanin për shitje ose përdorim nga pasagjerët në sasi të kufizuara gjatë fluturimit dhe artikuj të tjerë, si fletën shoqëruese të mallit të printuar, çdo material të printuar që ka logon e shoqërisë të printuar dhe materialet e zakonshme të publicitetit që shpërndahen falas nga ajo shoqëri ajrore e caktuar, që destinohet për përdorim ose përdoret vetëm në lidhje me operimin ose shërbimin e avionit të linjës ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese që operon shërbimet e rëna dakord.



2. Përfashtimet e dhëna nga ky nen zbatohen për artikujt e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat:

a) prezantohen në territorin e një Pale Kontraktuese nga ose në emër të linjës ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese, me kusht që këto artikuj të mund të kërkohen të mbahen nën kontrollin ose mbikëqyrjen doganore; ose

b) mbahen në bordin e avionit për përdorim nga linja ajrore e caktuar e një prej Palëve Kontraktuese me mbërritjen ose largimin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese; ose

c) merren në bordin e avionit nga linja ajrore e caktuar e një prej Palëve Kontraktuese në territorin Palës tjetër Kontraktuese dhe që destinohet për përdorim në operimin e shërbimeve ajrore të rëna dakord,

pavarësisht nëse këto artikuj përdoren ose konsumohen plotësisht brenda territorit të Palës Kontraktuese që jep përfashtimin, me kusht që pronësia mbi këto artikuj të mos transferohet në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

3. Përfashtimet e parashikuara nga ky nen zbatohen, gjithashtu, për rastet kur një linjë ajrore e caktuar e një Pale Kontraktuese ka hyrë në marrëveshje me një linjë tjetër ajrore për huadhënien ose transferimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të artikujve të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, me kusht që kjo linjë ajrore tjetër të gëzojë të njëjtën përfashtim nga Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 12

Konkurrenca e ndershme

Secila Palë Kontraktuese u jep linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, mundësi të drejtë dhe të barabartë, në pajtim me ligjet e saj të konkurrencës, për të operuar shërbimet e rëna dakord.

Neni 13

Kapaciteti

1. Secila Palë Kontraktuese i lejon çdo linjë ajrore të caktuar të përcaktojë shpeshhtësinë dhe kapacitetin e shërbimit ndërkombëtar ajror që ofron. Në pajtim me këtë të drejtë, asnjë Palë Kontraktuese nuk kufizon në mënyrë të njëanshme volumin e trafikut, shpeshhtësinë, ose rregullsinë e shërbimit ose tipin apo tipat e avionëve të operuar nga linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër

Kontraktuese, përveç kur kërkohet për shkaqe doganore, teknike, operacionale ose mjedisore, në kushte të barabarta në pajtim me nenin 15 të Konventës.

2. Asnjë Palë Kontraktuese nuk u vendos linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese kërkesën e refuzimit të parë, raportin e ngritjes, tarifën e moskundërshtimit ose ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me kapacitetin, shpeshhtësinë ose grafikun që nuk do të ishte në pajtim me qëllimet e Marrëveshjes.

3. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë depozitimin e grafikëve, programeve për shërbimet ajrore të paprogramuara ose planet operacionale nga linjat ajrore të Palës tjetër Kontraktuese për aprovim mbi bazë jodiskriminuese për të zbatuar kushte të barabarta. Nëse një Palë Kontraktuese kërkon depozitimet për qëllime informacioni, ajo minimizon barrën administrative për kërkesat dhe procedurat e depozitimit për ndërmjetësit e transportit ajror dhe për linjat e caktuara të Palës tjetër Kontraktuese.

4. Një linjë ajrore e caktuar e një Pale Kontraktuese u paraqet për aprovim autoriteteve aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë para datës së operimit të çdo shërbimi të rënë dakord, grafikun e shërbimeve të synuara, duke specifikuar shpeshhtësinë, tipin e avionit, konfigurimin dhe numrin e vendeve që i ofrohen publikut. E njëjta procedurë zbatohet për çdo ndryshim pasues të grafikëve të aprovuar të linjës ajrore të caktuar.

5. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese mund t'i japin njëra-tjetrës, me kërkesë, statistika periodike ose informacion tjetër të ngjashëm në lidhje me trafikun e kryer për shërbimet e rëna dakord.

Neni 14

Tarifat

1. Palët Kontraktuese bien dakord t'u kushtojnë vëmendje të veçantë tarifave që mund të jenë të kundërshtueshme pasi ato duken diskriminuese në mënyrë të paarsyeshme, tepër të larta ose kufizuese për shkak të abuzimit me pozitën dominuese, ose artificialisht të ulëta për shkak të subvencionit ose mbështetjes së drejtpërdrejtë qeveritare.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë njoftimin ose depozitimin e tarifave të propozuara nga linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër



Kontraktuese për transportin për në ose nga territori i saj. Ky njoftim ose depozitim mund të kërkohej jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së propozuar për prezantim. Në raste të veçanta, kjo periudhë mund të shkurtrohet.

Neni 15
Dërgimi i fitimeve

Çdo Palë Kontraktuese, në pajtim me ligjet e saj të brendshme, lejon linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, të konvertojnë dhe të dërgojnë jashtë shtetit në vendin e zgjedhur nga linja ajrore e caktuar, me kërkesë, të gjitha të ardhurat lokale nga shitja e shërbimeve ajrore dhe aktivitetet përkatëse të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet ajrore më të larta se shumatat e disbursuar lokalisht, ku konvertimi dhe dërgimi lejohen pa kufizim ose diskriminim dhe tatimi në lidhje me to është në normën e këmbimit që zbatohet në datën e kërkesës për konvertimin dhe dërgimin.

Neni 16
Aktivitetet tregtare

1. Çdo Palë Kontraktuese u jep linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, të drejtën për të shitur dhe tregtuar shërbimet ajrore ndërkombëtare dhe produktet përkatëse në territorin e saj, drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjentëve apo ndërmjetësve të tjerë sipas zgjedhjes së linjave ajrore të caktuara, duke përfshirë të drejtën për të ngritur zyra, të lidhura në rrjet ose jo.

2. Çdo linjë ajrore e caktuar ka të drejtën të shesë shërbime ajrore në monedhën e Palës tjetër Kontraktuese ose, në diskrecionin e saj, në monedha lirisht të këmbyeshme të vendeve të tjera, dhe çdo person është i lirë të blejë këto shërbime ajrore në monedhat e pranuar nga kjo linjë ajrore e caktuar.

3. Linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin, të sjellin dhe të mbajnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese personelin e tyre menaxherial, teknik, operacional ose specialistë të tjerë të cilët kërkohej për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare.

4. Linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të paguajnë për shpenzimet lokale, duke përfshirë blerjen e karburantit, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese

në monedhën lokale. Në diskrecionin e tyre, linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese mund të paguajnë për këto shpenzime në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në monedha lirisht të konvertueshme sipas rregulloreve lokale për parane.

Neni 17
Masat bashkëpunuese

1. Në operimin ose ofrimin e shërbimeve të rëna dakord në itineraret e specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje, linjat ajrore të caktuara të secilës Palë Kontraktuese lejohen të angazhohen në masa bashkëpunuese marketimi si hapësirë e bllokuar ose masat e kodeve të përbashkëta, me:

a) një ose disa linja ajrore të të njëjtës Palë Kontraktuese;

b) një ose disa linja ajrore të Palës tjetër Kontraktuese;

c) një ose disa linja ajrore të një vendi të tretë; dhe

d) një ofrues të transportit tokësor të çdo vendi, me kusht që,

i) të gjitha linjat ajrore në këto masa të kenë autoritetin përkatës për të operuar në itineraret dhe segmentet përkatëse; dhe

ii) në lidhje me çdo biletë të shitur, linja ajrore i bën të qartë blerësit në pikën e shitjes cila linjë ajrore do të operojë faktikisht në çdo sektor të shërbimit dhe me cilën ose cilat linja ajrore hyn në marrëdhënie kontraktuale blerësi.

2. Nëse një linjë ajrore e caktuar i operon shërbimet e rëna dakord sipas një mase me kod të njëjtë, si dhe linja ajrore operuese, kapaciteti i operuar llogaritet kundrejt të drejtave për kapacitet të Palës Kontraktuese që ka caktuar këtë linjë ajrore. Kapaciteti i mbuluar nga një linjë ajrore që vepron si linja ajrore marketuese për shërbimet e kodeve të njëjta të operuara nga linja ajrore të tjera, nuk llogaritet kundrejt të drejtave për kapacitet të Palës Kontraktuese që ka caktuar këtë linjë ajrore marketuese.

Neni 18
Qiramarrja e avionëve

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të parandalojë përdorimin e avionit të marrë me qira për shërbimet ajrore sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilët nuk përputhen me nenin 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) dhe nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit) të kësaj Marrëveshjeje.



2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, linjat ajrore të caktuara të secilës Palë Kontraktuese mund të përdorin avionin (ose avionin dhe ekuipazhin) të marrë me qira nga çdo shoqëri, duke përfshijë linja ajrore të tjera, me kusht që kjo të mos rezultojë në faktin që linja ajrore qiradhënëse të ushtrorë të drejta trafiku të cilat nuk i ka.

3. Masat e propozuara për qiradhënien i nënshtrohen aprovimit të autoriteteve aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese. Linja ajrore e caktuar që propozon përdorimin e avionit të marrë me qira u jep autoriteteve aeronautike të secilës Palë Kontraktuese, sa më parë të jetë e mundur, një njoftim për kushtet e propozuara për një masë të tillë.

4. Megjithatë, autoritetet aeronautike nuk e refuzojnë aprovimin e masave sipas të cilave linja ose linjat ajrore të caktuara të një Pale Kontraktuese marrin me qira avionë për arsye emergjence, me kusht që periudha e këtyre masave të mos kalojë 90 ditë dhe autoritetet aeronautike të njoftohen për kushtet e këtyre masave, duke përfshirë natyrën e emergjencës.

Neni 19

Shërbimet me transport të kombinuar

Çdo linjë ajrore e caktuar, në pajtim me ligjet e brendshme të Palëve Kontraktuese, lejohet të përdorë transportin e kombinuar, pa kufizim, në lidhje me shërbimet e saj ajrore ndërkombëtare për pasagjerë dhe/ose mallra.

Neni 20

Konsultimet

Përveç kur është parashikuar në nenin 8 (Siguria Teknike e Aviacionit) dhe nenin 9 (Siguria Fizike e Aviacionit) të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë Kontraktuese, në çdo kohë, mund të kërkojë konsultime për interpretimin, zbatimin, ose ndryshimin apo përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje. Këto konsultime, të cilat mund të jenë nëpërmjet diskutimeve ose me shkrim ndërmjet autoriteteve aeronautike, fillojnë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data kur Pala tjetër Kontraktuese merr një kërkesë me shkrim, përveç kur bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse ndërmjet Palëve Kontaktuese lind një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese fillimisht përpiqen ta zgjidhin me konsultime ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Nëse Palët Kontraktuese nuk arrijnë një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me konsultime ose rrugë diplomatike, ajo mund t'i referohet prej tyre atij personi ose organi për të cilin bien dakord ose, me kërkesë me shkrim të një Pale Kontraktuese, i paraqitet për vendim një gjykatë prej tre arbitrash, e cila krijohet në mënyrën e mëposhtme:

a) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas marrjes së një kërkesë me shkrim për arbitrazh, çdo Palë Kontraktuese cakton një arbitër. Një shtetas i një vendi të tretë, i cili vepron si Kryetar i gjykatës, caktohet si arbitër i tretë me marrëveshje ndërmjet dy arbitrave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga emërimi i arbitrit të dytë;

b) nëse brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafin “a”, të këtij neni, nuk është bërë një emërim, çdo Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë me shkrim Kryetarit të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, të bëjë emërimin e nevojshëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Nëse Kryetari është me të njëjtën shtetësi si ajo e një prej Palëve Kontraktuese, Zëvendëskryetari më të vjetër i kërkohet të bëjë emërimin. Nëse Zëvendëskryetari është me të njëjtën shtetësi si ajo e një prej Palëve Kontraktuese, Anëtarit të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil me vjetërsinë më të gjatë, i cili nuk është me të njëjtën shtetësi si ajo e një Pale Kontraktuese, i kërkohet të bëjë emërimin. Në këtë rast, arbitri i tretë i caktuar nga Kryetari ose Zëvendëskryetari ose Anëtari i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, sipas rastit, nuk është shtetas ose rezident i përhershëm i Shteteve përkatëse të Palëve Kontraktuese.

3. Përveç kur më poshtë është e parashikuar në këtë nen ose bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese, gjykata vendos kufijtë e juridiksionit të saj në pajtim me këtë Marrëveshje dhe vendos procedurën e saj. Me udhëzim të gjykatës ose me kërkesën me shkrim të një prej Palëve Kontraktuese, mbahet një seancë për të përcaktuar



saktësisht çështjet që duhet të gjykohen në arbitrazh dhe procedurat specifike që duhet të ndiqen jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pasi gjykata të jetë plotësuar.

4. Përveç kur bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese ose caktohet nga gjykata, çdo Palë Kontraktuese paraqet një memorandum brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga koha kur gjykata është plotësuar. Çdo Palë Kontraktuese mund të dorëzojë një përgjigje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas paraqitjes së memorandumit të Palës tjetër Kontraktuese. Gjykata zhvillon një seancë me kërkesë me shkrim të një Pale Kontraktuese, ose në diskrecionin e saj, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotësimit të afatit të përgjigjeve.

5. Gjykata përpiket të japë një vendim me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të seancës ose, nëse nuk zhvillohet seancë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas datës së paraqitjes së dy përgjigjeve. Vendimi merret me shumicë votash.

6. Palët Kontraktuese mund të paraqesin kërkesa me shkrim për sqarime mbi vendimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së tij dhe këto sqarime jepen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një kërkesë e tillë.

7. Vendimi i gjykatës është detyrues për Palët Kontraktuese.

8. Çdo Palë Kontraktuese përballon shpenzimet e arbitrit të caktuar prej saj. Shpenzimet e tjera të gjykatës mbulohen në pjesë të barabarta nga Palët Kontraktuese, duke përfshirë shpenzimet e bëra nga Kryetari, zëvendëskryetari ose anëtari i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, në zbatim të procedurave të paragrafit 2 të këtij neni.

9. Nëse dhe për sa kohë një Palë Kontraktuese nuk respekton vendimin e dhënë sipas paragrafit 7 të këtij neni, Pala tjetër Kontraktuese mund të kufizojë, refuzojë ose revokojë çdo të drejtë ose privilegj që ajo ka dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje Palës Kontraktuese, në vonesë ose linjë apo linjave ajrore të caktuara në vonesë.

Neni 22

Ndryshimet

1. Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë në çdo kohë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese për qëllimin e ndryshimit të kësaj Marrëveshjeje ose anekseve të saj. Këto konsultime fillojnë brenda një periudhe prej 60

(gjashtëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së një kërkesë të tillë. Këto konsultime mund të zhvillohen me diskutime ose korrespondencë.

2. Çdo ndryshim hyn në fuqi nëse konfirmohet nga një shkëmbim i notave diplomatike.

3. Çdo ndryshim i anekseve mund të bëhet me marrëveshje me shkrim ndërmjet autoriteteve aeronautike të Palëve Kontraktuese dhe hyn në fuqi nëse konfirmohet nga një shkëmbim i notave diplomatike.

Neni 23

Marrëveshjet shumëpalëshe

Nëse një marrëveshje shumëpalëshe mbi shërbimet ajrore hyn në fuqi në lidhje me të dyja Palët Kontraktuese, çdo mospërputhje e detyrimeve të Palëve Kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjes tjetër ndërmjet të dyja Palëve Kontraktuese, zgjidhet në favor të dispozitës/ave që parashikon për linjat ajrore të caktuara në masë më të madhe:

- a) ushtrimin e të drejtave;
- b) sigurinë e aviacionit; ose
- c) sigurinë e aviacionit,

përveç kur bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

Neni 24

Zgjidhja

Çdo Palë Kontraktuese, në çdo kohë, mund t'i japë njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, Palës tjetër Kontraktuese për vendimin e saj për të zgjidhur këtë Marrëveshje. Një njoftim i tillë i komunikohet njëkohësisht Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Kjo Marrëveshje zgjidhet 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, përveç kur njoftimi tërhiqet me marrëveshje para përfundimit të kësaj periudhe. Në mungesë të njohjes së marrjes nga Pala tjetër Kontraktuese, njoftimi konsiderohet të jetë marrë 14 (katërmëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

Neni 25

Regjistrimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje dhe çdo ndryshim i saj regjistrohen me hyrjen e saj në fuqi tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil nga Pala



Kontraktuese në territorin e së cilës është nënshkruar kjo Marrëveshje.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën kur merret njoftimi i fundit me shkrim me notë diplomatike që konfirmon se Palët Kontraktuese kanë përmbushur të gjitha procedurat përkatëse të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Singapor, më _____, në dy kopje në gjuhën angleze dhe shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentikë. Në rastin e një mospërputhjeje në interpretim ose mosmarrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë
19.1.2015

Ditmir Bushati

Ministër i Punëve të Jashtme

Për Qeverinë e Republikës
së Singaporit
9.3.2015

K. Shanmugam

Ministër i Punëve të
Jashtme dhe Ministër i
Drejtësisë

ANEKSI I GRAFIKU I ITINERARIT

Grafiku I

Itineraret që do të operohen nga linjat ajrore të caktuara të Shqipërisë:

Pikat e originës	Pikat e ndërmjetme	Pikat e destinacionit	Pika të mëtejshme
Çdo pikë në Shqipëri	Çdo pikë	Çdo pikë në Singapor	Çdo pikë

Grafiku II

Itineraret që do të operohen nga linjat ajrore të caktuara të Singaporit:

Pikat e originës	Pikat e ndërmjetme	Pikat e destinacionit	Pika të mëtejshme
Çdo pikë në Singapor	Çdo pikë	Çdo pikë në Shqipëri	Çdo pikë

dhe anasjellas.

1. Gjatë operimit të një shërbimi të rënë dakord në një itinerar të specifikuar, çdo linjë ajrore, përveç të drejtave të specifikuara në nenin 2 (Dhënia e të drejtave) të kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha të drejtat dhe sipas zgjedhjes së saj:

a) i operon fluturimet në një ose të dy drejtimet;
b) i kombinon në numra të ndryshëm fluturimesh në operimin e të njëjtit avion;

c) shërben pikat e ndërmjetme dhe të mëtejshme dhe pikat në territoret e Palëve Kontaktuese (duke përfshirë pikat bashkë-terminale) në itineraret në çdo kombinim dhe në çdo renditje;

d) nuk bën ndalimet në një ose disa pika;

e) transferon trafikun, duke përfshirë masat me kode të përbashkëta, nga një avion i caktuar në një avion tjetër të caktuar në çdo pikë të itinerarit;

f) shërben pikat prapa çdo pike në territorin e vet me ose pa ndryshuar avionin ose numrin e fluturimit dhe mund t'u ofrojë dhe të reklamojë këto shërbime në publik gjatë dhënies së shërbimeve; dhe

g) bën ndalesa ndërmjet pikave të ndryshme brenda ose jashtë territorit të Palëve Kontraktuese;

pa kufizim diskrecional ose gjeografik dhe pa humbjen e asnjë të drejte për të kryer transport i cili normalisht lejohet nga kjo Marrëveshje; me kusht që, me përjashtim të shërbimeve me mallra të ndryshëm, shërbimi t'i shërbejë një pike në territorin e Palës Kontraktuese që ka caktuar linjën ajrore.

2. Në çdo segment ose segmente të itinerareve të mësipërm, çdo linjë ajrore e caktuar mund të kryejë transport ajror ndërkombëtar pa kufizim në lidhje me ndryshimin, në çdo pikë të itinerarit, në tipin ose numrin e avionit të operuar, me kusht që, me përjashtim të shërbimeve me mallra të ndryshëm, në kahun e vajtjes, transporti te një pikë e tillë është vazhdim i transportit nga territori i Palës Kontraktuese që ka caktuar linjën ajrore dhe, në kahun e kthimit, transporti në territorin e Palës Kontraktuese që ka caktuar linjën ajrore është vazhdim i transportit nga tej kësaj pike.

3. Linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të ndërpresin shërbimet e tyre ajrore në territorin Palës tjetër Kontraktuese.

ANEKSI II SHËRBIMET AJRORE TË PAPLANIFIKUARA/ÇARTER

1. Linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të operojnë shërbimet ajrore të paplanifikuara ndërmjet Palëve Kontraktuese. Linjat ajrore duhet të kërkojnë



paraprkisht leje nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese. Këto kërkesa zakonisht paraqiten të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune përpara operimit të këtyre shërbimeve ajrore.

2. Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e veta, shërbimet ajrore të paplanifikuara/çarter të linjave ajrore të caktuara të secilës Pale Kontraktuese nuk cenojnë në mënyrë të parregullt operimin e shërbimeve të itinerareve të rëna dakord.

LIGJ

Nr. 149/2015

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR DHE TË REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti ndryshues i marrëveshjes së huas ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të Bulevardit Verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.12.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9381, datë 6.1.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

FONDI PËR ZHVILLIM ABU DHABI

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Ref. 373

Datë 4.3.2014

Shkëlqesisë së Tij, Z. Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Republika e Shqipërisë

Tel. +355 4 2228405

Shkëlqesia Juaj,

Lënda: Projekti i Rehabilitimit të Bulevardit Verior dhe Lumit të Tiranës, Republika e Shqipërisë

I referohemi mbledhjes së zhvilluar në zyrat tona, në datën 5 shkurt 2015, me pjesëmarrjen e Shkëlqesisë së Tij, ambasadorit Shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe përfaqësuesit të Bashkisë së Tiranës, në emër të përfituesit në lidhje me projektin e subjektit dhe shkresën me numër protokollit 2280, të datës 11.2.2014, që jep sqarime të mëtejshme në skedulit II të Marrëveshjes.

Në vijim të diskutimit tonë dhe marrëveshjes së përbashkët dhe dhënies së pëlqimit të përfituesit të projektit, Bashkisë së Tiranës, ne kemi rishikuar skedulit II të Marrëveshjes për të reflektuar gjendjen aktuale të projektit siç është parashikuar në fazën e vlerësimit të tij. Ju bëjmë me dije se ky rishikim nuk do të ndikojë në termat dhe kushtet e projektit dhe as nuk do të ketë ndonjë ndikim financiar në marrëveshjen e huas dhe skedulit në fjalë, të ndryshuar, të cilat mbeten subjekt i marrëveshjes së huas të nënshkruar më herët në datën 21.4.2013.

Bashkëlidhur gjeni 3 grupe të skedulit II të rishikuar. I lutemi Shkëlqesisë Suaj të nënshkruajë të gjithë kopjet, të mbajë një prej grupeve dhe të na ktheni 2 grupet e tjera.

Me respekt

Mohammed Saif Al Suwaidi

Drejtor i Përgjithshëm

SKEDULI II "I NDRYSHUAR"

1. Objektivat e projektit

Objektivi i projektit është që të ndihmojë në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit përmes zhvillimit të Bulevardit Verior të Tiranës, përmirësimit të ujëmbledhësit dhe bregut të Lumit



të Tiranës si edhe mbështetjes së investimeve, objektivave/ambienteve të kohës së lirë dhe turizmit në zonë.

2. Përshkrimi i projektit

Projekti konsiston në ndërtimin real të objekteve të mëposhtme:

- Rehabilitimi i shtratit të lumit, i bregut dhe zonave të afërta;

- Ndërtimi i zonës së Bulevardit dhe punimet civile të lidhura me të;

- Ndërtimi i rrugës së Unazës;

- Përgatitja e infrastrukturës për rritjen e turizmit dhe për lehtësimin dhe tërheqjen e ndërtimit të objektivave tregtare.

Kontributi i Fondit do të mbulojë plotësisht rehabilitimin e lumit dhe bregut të tij, ndërtimin e bulevardit verior (pjesa e parë) dhe shërbimet e konsulencës teknike të përshkruara në raportin e vlerësimit të projektit, të cilat përfaqësojnë 50% të të gjithë projektit. Pjesët e tjera të projektit që përbëhen kryesisht nga rruga e unazës, pjesa e dytë e bulevardit, punimet infrastrukturore etj., do të mbulohen nga Bashkia e Tiranës.

3. Lista e mallrave

Nr.	Zëri	Shuma	% e financimit
1	Punime rehabilitimi të lumit dhe bregut të tij dhe të gjitha punët civile dhe të ndërtimit të lidhura me to	90 000 000	100%
2	Ndërtimi i zonës së bulevardit dhe punimet civile të lidhura me të (pjesa e parë)	120 000 000	100%
3	Shërbime teknike dhe të konsulencës	10 000 000	100%
4	Kontingjencat e projektit	20 000 000	100%
	Totali	240 000 000	100%

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Për Fondin për Zhvillim Abu Dhabi

Mohammed Saif Al Suwaid

Drejtor i Përgjithshëm

LIGJ

Nr. 150/2015

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË ORGANEVE NJERËZORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës Kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore, nënshkruar në Santiago de Compostela më 25 mars 2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9382, datë 6.1.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË ORGANEVE NJERËZORE

Parathënie

Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruet të tjerë të kësaj Konvente;

duke pasur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948 dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950, ETS nr. 5);

duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Dinjitetin e Njeriut në lidhje me Aplikimin e Biologjisë dhe Mjekësisë: Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë (1997, ETS nr. 164) dhe Protokollin Shtesë të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësisë në lidhje me Transplantimin e Organeve dhe Indeve të Originës Njerëzore (2002, ETS nr. 186);



duke pasur parasysh Protokollin për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës kundër Krimit të Organizuar, e Kombeve të Bashkuara (2000) dhe Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2005, CETS nr. 197);

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh se trafikimi i organeve njerëzore cenon dinjitetin njerëzor dhe të drejtën e jetës dhe përbën një kërcënim serioz për shëndetin publik;

të vendosur për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për çrrënjosjen e trafikimit të organeve njerëzore nëpërmjet përfshirjes së veprave të reja, duke plotësuar instrumentet ekzistuese ligjore ndërkombëtare në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim heqjen e organeve;

duke pasur parasysh se qëllimi i kësaj Konvente është të parandalojë dhe të luftojë trafikimin e organeve njerëzore dhe se zbatimi i dispozitave të Konventës, në lidhje me të drejtën materiale penale, duhet të kryhet duke marrë parasysh qëllimin e saj dhe parimin e proporcionalitetit;

duke pranuar se për të luftuar në mënyrë efektive kërcënimin global, të përfaqësuar nga trafikimi i organeve njerëzore, duhet të nxitet bashkëpunimi i ngushtë ndërkombëtar ndërmjet shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe shteteve joanëtare të ngjashme,

kanë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I QËLLIMET, OBJEKTI DHE PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1 Qëllimet

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) Parandalimi dhe luftimi i trafikimit të organeve njerëzore, duke mundësuar kriminalizimin e akteve të caktuara;

b) mbrojtja e të drejtave të viktimave të veprave penale, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë;

c) lehtësimi i bashkëpunimit në nivele kombëtare dhe rajonale mbi veprimet kundër trafikimit të organeve njerëzore.

2. Për të garantuar zbatimin efektiv të dispozitave të saj nga Palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik ndjekjeje.

Neni 2

Objekti dhe përdorimi i termave

1. Kjo Konventë zbatohet për trafikimin e organeve njerëzore për qëllimin e transplantimit apo qëllime të tjera dhe për forma të tjera të heqjes dhe implantimit të paligjshëm.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, termat:

- “trafikimi i organeve njerëzore” do të thotë çdo veprimtari e paligjshme në lidhje me organet njerëzore, siç parashikohet në nenin 4, paragrafi 1 dhe nenet 5, 7, 8 dhe 9 të kësaj Konvente;

- “organ njerëzor” do të thotë një pjesë e diferencuar në trupit e njeriut, e formuar nga inde të ndryshme që ruan strukturën e saj, vaskularizimin dhe kapacitetin për të zhvilluar funksione fiziologjike me një nivel të konsiderueshëm autonomie. Një pjesë e një organi është konsideruar, gjithashtu, të jetë një organ nëse funksioni i tij është që do të përdoret për të njëjtin qëllim si i gjithë organi në trupin e njeriut, duke ruajtur kërkesat e strukturës dhe vaskularizimit.

Neni 3

Parimet e mosdiskriminimit

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht gëzimin e masave për të mbrojtur të drejtat e viktimave, do të garantohet pa diskriminim mbi çfarëdo baze, si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, mosha, feja, politika ose ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, paaftësia apo ndonjë status tjetër.

KAPITULLI II LIGJI PENAL MATERIAL

Neni 4

Heqja e paligjshme e organeve njerëzore

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepër penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me



qëllim heqja e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë apo të vdekur:

a) kur heqja është kryer pa pëlqimin e lirë, të vetëdijshëm dhe specifik të dhuruesit të gjallë apo të vdekur ose në rastin e dhuruesit të vdekur, pa largimin e autorizuar sipas ligjit të tij të brendshëm;

b) kur në këmbim të heqjes së organeve, dhuruesit të gjallë ose një pale të tretë i është ofruar ose ka marrë një fitim financiar ose avantazh të krahasueshëm;

c) kur në këmbim të heqjes së organeve, dhuruesit të vdekur ose një pale të tretë i është ofruar ose ka marrë një fitim financiar ose avantazh të krahasueshëm.

2. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, sipas një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se rezervon të drejtën të moszbatojë paragrafin 1/a të këtij neni në heqjen e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë, në raste të jashtëzakonshme dhe në përputhje me garancitë e duhura ose dispozitat e pëlqimit sipas ligjit të brendshëm.

Çdo rezervë e bërë sipas këtij paragrafi duhet të përmbajë një deklaratë të shkurtër të ligjit përkatës të brendshëm.

3. Shprehja “fitim financiar apo avantazh i krahasueshëm”, për qëllime të paragrafit 1/b dhe “c”, nuk përfshin kompensim për humbjen e të ardhurave dhe të gjitha shpenzimet e tjera të arsyeshme të shkaktuara nga largimi apo nga provimet përkatëse mjekësore ose kompensimin në rast dëmtimi, i cili nuk është i trashëguar në heqjen e organeve.

4. Secila Palë do të marrë në konsideratë marrjen e masave të nevojshme legislative apo të tjera për të përcaktuar si vepra penale, sipas ligjit të brendshëm, heqjen e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë apo të vdekur kur heqja kryhet jashtë kuadrit të sistemit të transplantimit të brendshëm ose kur heqja është kryer në shkelje të parimeve themelore të ligjeve ose rregullave kombëtare të transplantit. Nëse një Palë përcakton veprat penale në përputhje me këtë dispozitë, ajo duhet të përpiqet të zbatojë edhe nenet 9 deri 22, për vepra të tilla.

Neni 5

Përdorimi i organeve të hequra në mënyrë të paligjshme për qëllime implantimi apo qëllime të tjera

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim, përdorimin e organeve të hequra në mënyrë të paligjshme, siç përshkruhet në nenin 4, paragrafi 1, për qëllime implantimi apo qëllime të tjera.

Neni 6

Implantimi i organeve jashtë sistemit të brendshëm të transplantit ose në kundërshtim me parimet themelore të ligjit të brendshëm të transplantit

Secila Palë do të marrë në konsideratë marrjen e masave të nevojshme legislative apo të tjera për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit të brendshëm heqjen e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë apo të vdekur kur heqja kryhet jashtë kuadrit të sistemit të transplantimit të brendshëm ose kur heqja është kryer në shkelje të parimeve themelore të ligjeve ose rregullave kombëtare të transplantit. Nëse një Palë përcakton veprat penale në përputhje me këtë dispozitë, ajo duhet të përpiqet të zbatojë edhe nenet 9 deri 22, për vepra të tilla.

Neni 7

Nxitja e paligjshme, rekrutimi, oferta dhe kërkesa për avantazheve të padrejta

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepra penale, sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim, nxitjen dhe rekrutimin e një dhuruesi të organeve ose një marrësi, ku kryhet për përfitime financiare apo avantazhi të krahasueshëm për personin e nxitur ose të rekrutuar, ose për një palë të tretë.

2. Secila Palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, ofrimin ose dhënien nga çdo person, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të ndonjë avantazhi të padrejtë të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, zyrtarëve të tij publikë ose personave që drejtojnë ose punojnë për subjektet e sektorit privat, në çfarëdo cilësie, me synimin për të pasur një heqje ose implantimin të një organi njerëzor, kur heqje apo implantime të tilla



zhvillohen në bazë të rrethanave të përshkruara në nenin 4, paragrafi 1 ose nenin 5 dhe kur është e përshtatshme nenin 4, paragrafi 4 ose nenin 6.

3. Secila Palë do të marrë masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të përcaktuar si veprë penale, kur kryhen qëllimisht, ofrimin ose dhënien nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, zyrtarëve të tij publikë ose personave që drejtojnë ose punojnë për subjektet e sektorit privat, në çfarëdo cilësie, me synimin për të pasur një heqje ose implantimin e një organi njerëzor, kur heqje apo implantime të tilla zhvillohen në bazë të rrethanave të përshkruara në nenin 4, paragrafi 1 ose nenin 5 dhe kur është e përshtatshme nenin 4, paragrafi 4 ose nenin 6.

Neni 8

Përgatitja, ruajtja, transportimi, transferimi, pranimi, importimi dhe eksportimi i organeve njerëzore të hequra në mënyrë të paligjshme

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të përcaktuar si veprë penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim:

a) Përgatitjen, ruajtjen e organeve njerëzore të hequra në mënyrë të paligjshme siç është përshkruar në nenin 4, paragrafi 1, dhe kur është e përshtatshme, nenin 4, paragrafi 4;

b) transportimin, transferimin, pranimin, importimin dhe eksportimin e organeve të hequra në mënyrë të paligjshme, siç është përshkruar në nenin 4, paragrafi 1 dhe kur është e përshtatshme, nenin 4, paragrafi 4.

Neni 9

Ndihma ose mbështetja dhe përpjekja

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, ndihmën ose mbështetjen për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, ndihmën ose mbështetjen për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

3. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të

ratifikimit, pranimit ose miratimit, sipas një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se rezervon të drejtën të moszbatojë paragrafin 2 për veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin 7 dhe nenin 8.

Neni 10

Juridiksioni

1. Secila palë do të marrë ato masa legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin mbi çdo veprë penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, kur vepra është kryer:

a) në territorin e saj; ose

b) në bordin e një anijeje që mban flamurin e asaj Pale; ose

c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj Pale; ose

d) nga një shtetas i saj; ose

e) nga një person i cili ka vendbanimin në territorin e saj.

2. Secila palë do të marrë ato masa legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin mbi çdo veprë penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, kur vepra është kryer kundër një personi ose shtetasi i cili ka vendbanimin në territorin e saj.

3. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, sipas një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se rezervon të drejtën të zbatojë ose jo vetëm në raste apo kushte specifike rregullat e juridiksionit, të përcaktuara në paragrafin 1/d dhe “e” të këtij neni.

4. Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të garantuar që juridiksioni i saj në lidhje me paragrafët 1/d dhe “e” të këtij neni nuk është në varësi të kushtit që ndjekja penale mund të fillojë vetëm pas një kallëzimi nga viktimat apo paraqitjes së informacionit nga shteti i vendit ku është kryer vepra.

5. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, sipas një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se rezervon



të drejtën të zbatojë ose jo vetëm në raste apo kushte specifike të përcaktuara në paragrafin 4.

6. Secila Palë do të marrë masat e nevojshme legislative apo të tjera për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, në rastet kur një shkelës i dyshuar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në një shtet tjetër, vetëm në bazë të shtetësisë së tij apo të saj.

7. Kur më shumë se një Palë pretendon juridiksion mbi një vepër të dyshuar të përcaktuar sipas kësaj Konvente, Palët e përfshira, sipas nevojës, konsultohen me qëllim vendosjen e juridiksionit të duhur për ndjekjen penale.

8. Pa rënë ndesh me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar nga një Palë në përputhje me ligjin e saj të brendshëm.

Neni 11

Përgjegjësia korporative

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që personat juridikë mund të mbajnë përgjegjësi për veprat penale, të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, kur kryhen për përfitimin e tyre nga çdo person fizik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka një pozicion drejtues brenda tij bazuar në:

- a) një fuqi përfaqësimi të personit juridik;
- b) një autoritet për të marrë vendime në emër të personit juridik;
- c) një autoritet që të ushtrojë kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që një person juridik mund të konsiderohet përgjegjës kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik i referuar në paragrafin 1 ka mundësuar kryerjen e një veprë penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente në dobi të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.

3. Duke iu nënshtuar parimeve ligjore të Palës, përgjegjësia e personit juridik mund të jetë penale, civile ose administrative.

4. Kjo përgjegjësi nuk do të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprën penale.

Neni 12

Sanksionet dhe masat

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që veprat e përcaktuara në përputhje me këtë Konventë të dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse. Këto sanksione do të përfshijnë, për veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin 4, paragrafi 1 dhe, kur është e përshtatshme, nenin 5 dhe nenet 7 deri 9, kur kryhen nga persona fizikë, dënime që përfshijnë heqjen e lirisë që mund të çojë në ekstradim.

2. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që personat juridikë, që janë përgjegjës në përputhje me nenin 11, t'u nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale dhe bindëse, përfshirë edhe sanksionet monetare penale ose jopenale dhe mund të përfshijnë masa të tjera të tilla si:

- a) shkualifikimi i përkohshëm ose i përhershëm nga ushtrimi i veprimtarisë tregtare;
- b) vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore;
- c) urdhri gjyqësor.

3. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera, për të:

- a) lejuar sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë ose pasurisë, vlera e së cilave i korrespondon këtyre produkteve;
- b) mundësimi i bllokimit të përkohshëm ose të përhershëm të çdo organizate të përdorur për të kryer ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, pa cenuar të drejtat e palëve të treta në *bona fide* (mirëbesim) apo për t'i mohuar autorëve, përkohësisht ose përgjithmonë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, ushtrimin e një veprimtarie profesionale përkatëse për kryerjen e një prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 13

Rrethanat rënduese

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që rrethanat e mëposhtme, për aq kohë sa nuk janë pjesë e elementeve përbërëse të veprës, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese në përcaktimin e sanksioneve në lidhje me veprat



penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë:

- a) vepra shkaktoi vdekjen e, apo dëme serioze në shëndetin fizik ose mendor të viktimës;
- b) shkelja është kryer nga një person i cili ka abuzuar me detyrën e tij/saj;
- c) vepra penale është kryer në kuadër të një organizate kriminale;
- d) autori ka qenë më parë i dënuar për veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë;
- e) vepra penale është kryer kundër një fëmije ose ndonjë personi tjetër të rrezikuar.

Neni 14

Dënime të mëparshme

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të parashikuar mundësinë për të marrë parasysh dënimet e formës së prerë, të miratuara nga një Palë tjetër në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë kur përcaktohen sanksionet.

KAPITULLI III

LIGJI I PROCEDURËS PENALE

Neni 15

Fillimi dhe vazhdimi i procedimeve

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, nuk duhet të jetë në varësi të një ankese dhe që procedimet mund të vazhdojnë edhe nëse ankesa është tërhequr.

Neni 16

Hetimet penale

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera, në përputhje me parimet e ligjit të tij të brendshëm, për të garantuar hetimin efektiv penal dhe ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 17

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe në zbatim të instrumenteve të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale dhe marrëveshjet e rena dakord në bazë të legjislacionit uniform ose

reciprok dhe ligjin e tyre të brendshëm, në masën më të gjerë të mundshme, për qëllime të hetimeve ose procedurave në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin.

2. Palët do të bashkëpunojnë në masën më të gjerë të mundshme, në zbatim të traktateve përkatëse ndërkombëtare të zbatueshme, rajonale dhe dypalëshe, për ekstradim dhe ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale në lidhje me veprat e përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

3. Nëse një Palë që realizon ekstradimin ose ndihmë ligjore të ndërsjellë në çështjet penale të kushtëzuara nga ekzistenca e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim apo ndihmë juridike në çështjet penale nga një Palë me të cilin nuk ka një traktat të tillë, duke vepruar në përputhje të plotë me detyrimet e saj sipas së drejtës ndërkombëtare dhe në kushtet e parashikuara nga ligji i brendshëm i Palës së kërkuar, ajo mund të konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin ose ndihmën e ndërsjellë juridike në çështje penale në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

KAPITULLI IV

MASAT E MBROJTJES

Neni 18

Mbrojtja e viktimave

Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave të veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, në veçanti:

- a) duke garantuar që viktimat të kenë qasje në informacionet përkatëse për rastin e tyre dhe që është i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe të të drejtave të tjera të përfshira;
- b) duke ndihmuar viktimat në rikuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe social;
- c) duke parashikuar, në ligjin e saj të brendshëm, të drejtën e viktimave për kompensim nga autorët.

Neni 19

Pozicioni i viktimave në procedime penale

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave në të gjitha fazat e hetimeve penale dhe procedimeve, në veçanti:



a) duke i informuar për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe, sipas kërkesës, ndjekjen që i jepet ankesës së tyre, akuzat, fazën e procedimeve penale, përveç kur në raste të veçanta trajtimi i duhur i rastit mund të ndikohet negativisht nga një njoftim i tillë, si dhe rolin e tyre në to dhe rezultatet e rasteve të tyre;

b) duke u lejuar atyre, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, për t'u dëgjuar, për të mbledhur prova dhe për paraqitjen dhe shqyrtimin e pikëpamjeve të tyre, nevojave dhe shqetësimeve, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi;

c) duke u ofruar shërbimet e duhura mbështetëse në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;

d) duke garantuar masa efektive për sigurinë e tyre, si dhe të familjeve të tyre, nga kërcënimet dhe hakmarrja.

2. Secila palë do të garantojë që viktimat të kenë qasje që nga kontakti i parë me autoritetet kompetente, në informacionin mbi procedimet përkatëse gjyqësore dhe administrative.

3. Secila palë do të garantojë që viktimat të kenë qasje në ndihmë juridike, në pajtim me ligjin e brendshëm dhe të jepet falas, kur është e mundur për ta që të kenë statusin e palëve në procedimin penal.

4. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar që viktimat e një veprë penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë të kryer në territorin e një Pale të ndryshme nga ajo ku ata banojnë, mund të paraqesin një ankim tek autoritetet kompetente të Shtetit të tyre të vendbanimit.

5. Secila palë do të garantojë, me anë të masave legislative ose të tjera, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i brendshëm, mundësinë për grupet, fondacionet, shoqatat ose organizatat qeveritare apo joqeveritare, për të ndihmuar dhe/ose mbështetur viktimat me pëlqimin e tyre gjatë procedimeve penale në lidhje me veprat e përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 20

Mbrojtja e dëshmitarëve

1. Çdo Palë, brenda mundësive të saj dhe në pajtim me kushtet e parashikuara nga ligji i brendshëm, do të sigurojë mbrojtje efektive nga hakmarrja ose kërcënimi i mundshëm për

dëshmitarët në procedura penale, që japin dëshmi në lidhje me veprat penale të mbuluara nga kjo Konventë dhe sipas nevojës, për të afërmit e tyre dhe persona të tjerë të afërt me ta.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohet edhe për viktimat në masën që ata janë dëshmitarë.

KAPITULLI V

MASAT PARANDALUESE

Neni 21

Masat në nivel të brendshëm

1. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të garantuar:

a) ekzistencën e një sistemi të brendshëm transparent për transplantimin e organeve të njeriut;

b) një qasje të barabartë në shërbimet e transplantimit për pacientët;

c) grumbullimin e përshtatshëm, analizën dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë në bashkëpunim mes të gjitha autoriteteve përkatëse.

2. Me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të organeve njerëzore, çdo Palë do të marrë masa, sipas nevojës:

a) për të dhënë informacion ose forcimin e trajnimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe zyrtarëve përkatës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të organeve njerëzore;

b) për të promovuar fushatat e ndërgjegjësimit drejtuar publikut të përgjithshëm në lidhje me paligjshmërinë dhe rreziqet e trafikimit të organeve njerëzore.

3. Secila palë do të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të ndaluar reklamimin ose disponueshmërinë e organeve njerëzore, me synimin për të ofruar ose kërkuar përfitim financiar apo avantazh të krahasueshëm.

Neni 22

Masat në nivel ndërkombëtar

Palët, në masën më të gjerë të mundshme, do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën me qëllim parandalimin e trafikimit të organeve njerëzore. Në veçanti, Palët do të:

a) raportojnë te Komiteti i Palëve, me kërkesën e saj, për numrin e rasteve të trafikimit të organeve njerëzore brenda juridiksioneve të tyre përkatëse;



b) caktojnë një pikë kombëtare kontakti për shkëmbimin e informacionit që lidhet me trafikimin e organeve njerëzore.

KAPITULLI VI MEKANIZMI I NDJEKJES

Neni 23

Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve do të përbëhet nga përfaqësues të Palëve në Konventë.

2. Komiteti i Palëve do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Takimi i tij i parë do të zhvillohet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për të dhjetë nënshkruesit që e kanë ratifikuar atë. Ajo do të takohet më pas sa herë që të paktën një e treta e palëve ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkon një gjë të tillë.

3. Komiteti i Palëve do të miratojë rregullat e veta të procedurës.

4. Komiteti i Palëve do të ndihmohet nga Sekretariati i Këshillit të Evropës në kryerjen e funksioneve të tij.

5. Një palë kontraktuese që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës do të kontribuojë në financimin e Komitetit të Palëve në një mënyrë që do të vendoset nga Komiteti i Ministrave, me konsultimin e asaj Pale.

Neni 24

Përfaqësuesit e tjerë

1. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komiteti Evropian për Problemet e Krimit (CDPC), si edhe komitete të tjera përkatëse të Këshillit të Evropës ndërqeveritare ose shkencore, do të caktojnë një përfaqësues në Komitetin e Palëve për të kontribuar për një qasje multisektoriale dhe multidisiplinore.

2. Komiteti i Ministrave mund të ftojë organe të tjera të Këshillit të Evropës për të emëruar një përfaqësues në Komitetin e Palëve pas konsultimit të këtij të fundit.

3. Përfaqësuesit e organeve përkatëse ndërkombëtare mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve në vijim të procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

4. Përfaqësuesit e organeve përkatëse zyrtare të Palëve mund të pranohen si vëzhgues në

Komitetin e Palëve në vijim të procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

5. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe në veçanti organizatat joqeveritare, mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve në vijim të procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

6. Në emërimin e përfaqësuesve të paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni, do të garantohet një përfaqësim i balancuar i sektorëve dhe disiplinave të ndryshme.

7. Përfaqësuesit e emëruar sipas paragrafëve 1 deri 5 më sipër do të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Palëve pa të drejtë vote.

Neni 25

Funksionet e Komitetit të Palëve

1. Komiteti i Palëve do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente. Rregullat e procedurës së Komitetit të Palëve do të përcaktojnë procedurën për vlerësimin e zbatimit të kësaj Konvente, duke përdorur një qasje multisektoriale dhe multidisiplinore.

2. Komiteti i Palëve do të lehtësojë mbledhjen, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe praktikës së mirë ndërmjet shteteve për të përmirësuar kapacitetin e tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e organeve njerëzore. Komiteti mund të përfitojë nga ekspertiza e komiteteve të tjera përkatëse të Këshillit të Evropës dhe organeve.

3. Për më tepër, Komiteti i Palëve, kur është e përshtatshme, duhet:

a) të lehtësojë përdorimin efektiv dhe zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi që mund të lindë dhe efektet e çdo deklarate ose rezerve të bërë sipas kësaj Konvente;

b) të shprehë një opinion mbi çdo çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore, politike apo teknologjike;

c) të bëjë rekomandime të veçanta për Palët në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente.

4. Komiteti Evropian për Problemet e Krimit (CDPC) do të mbahet i informuar periodikisht në lidhje me aktivitetet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.



KAPITULLI VII MARRËDHËNIET ME INSTRUMENTET E TJERA NDËRKOMBËTARE

Neni 26

Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk do të ndikojë te të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e instrumenteve të tjera ndërkombëtare në të cilat Palët në këtë Konventë janë palë ose do të bëhen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita për çështje që rregullohen nga kjo Konventë.

2. Palët në Konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëra-tjetrën për çështjet që trajtohen në këtë Konventë, me qëllim plotësimin ose përforsimin e dispozitave të saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që mishëron.

KAPITULLI VIII AMENDAMENTET E KONVENTËS

Neni 27

Ndryshimet

1. Çdo propozim për një amendament të kësaj Konvente i paraqitur nga një Palë do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe do të përcillet nga ai apo ajo te shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shtetet joanëtare që gëzojnë statusin e vëzhguesit me Këshillin e Evropës, Bashkimi Evropian dhe çdo shtet që është ftuar për të nënshkruar këtë Konventë.

2. Çdo amendament i propozuar nga një Palë do t'i komunikohet Komitetit Evropian për Problemet e Krimit (KEPK) dhe komisionet e tjera përkatëse të Këshillit të Evropës ndërqeveritare ose shkencore, i cili i paraqet Komitetit të Palëve mendimet e tyre për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës do të shqyrtojë amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti i Palëve dhe, pas konsultimit me Palët në këtë Konventë që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës, mund të miratojë amendamentin nga shumica e parashikuar në nenin 20/d të Statutit të Këshillit të Evropës.

4. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do t'i transmetohet Palëve për pranim.

5. Çdo amendament i miratuar në përputhje me

paragrafin 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

KAPITULLI IX KLAUZOLA TË FUNDIT

Neni 28

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe shteteve joanëtare që gëzojnë statusin e vëzhguesit pranë Këshillit të Evropës. Ajo gjithashtu do të jetë e hapur për nënshkrim nga çdo shtet tjetër joanëtar i Këshillit të Evropës me ftesë të Komitetit të Ministrave. Vendimi për të ftuar një vend joanëtar për të nënshkruar Konventën do të merret me shumicën e parashikuar në nenin 20/d të Statutit të Këshillit të Evropës, dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtë të veprojnë si anëtarë në Komitetin e Ministrave. Ky vendim do të merret pasi të ketë marrë miratimin unanim të vendeve të tjera/Bashkimit Evropian që kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur ligjërisht nga kjo Konventë.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën pesë nënshkruesit, duke përfshirë shtetet e të paktën tre anëtarëve të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo shtet ose Bashkimit Evropian, i cili e shpreh pëlqimin e tij për t'u detyruar ligjërisht nga kjo Konventë, ai do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 29

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të



ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Palë, në çdo datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të cilit është e autorizuar të lidhë marrëveshje. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 30 Rezervat

1. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të deklarojë se shfrytëzon një ose më shumë nga rezervat e parashikuara në nenet 4, paragrafi 2; 9, paragrafi 3; 10, paragrafët 3 dhe 5.

2. Gjithashtu, çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose rrëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të zbatuar Nenin 5 dhe nenin 7, paragrafët 2 dhe 3, vetëm kur veprat penale janë kryer për qëllimet e implantimit ose për qëllime të implantimit dhe qëllime të tjera të përcaktuara nga Pala.

3. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë tjetër.

4. Çdo Palë që ka bërë një rezervë, në çdo kohë mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 31

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Komiteti i Palëve, në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Evropian për Problemet e Krimin (KEPK) dhe komitetet e tjera përkatëse ndërqeveritare të Këshillit të Evropës apo komitetet shkencore, do të ndjekë zbatimin e kësaj Konvente dhe do të lehtësojë, kur është e nevojshme, edhe zgjidhjen me pajtim të të gjitha vështrësive të lidhura në zbatim të saj.

Neni 32

Denoncimi

1. Çdo Palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 33

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, shtetet joanëtare që gëzojnë statusin e vëzhguesit me Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian dhe çdo shtet që është ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 28, për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 28;
- d) çdo amendament të miratuar në përputhje me nenin 27 dhe datën në të cilën një amendament i tillë hyn në fuqi;
- e) çdo rezervë dhe tërheqje rezerve të bërë në zbatim të nenit 30;
- f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 32;
- g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në [Santiago de Compostela], më [25 mars 2015], në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila



depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, shteteve joanëtare që gëzojnë statusin e vëzhguesit në Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian dhe çdo shteti të ftuar për nënshkrimin e kësaj Konvente.

LIGJ
Nr. 151/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE HUNGARISË PËR
MBROJTJEN SHOQËRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, dhe 121, pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.12.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9383, datë 6.1.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE HUNGARISË PËR
MBROJTJEN SHOQËRORE**

Republika e Shqipërisë dhe Hungaria, më poshtë të quajtura “Palët Kontraktuese”, të nxitura nga dëshira për të vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet e tyre në fushën e mbrojtjes shoqërore, kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “territor” do të thotë, për sa i përket Republikës së Shqipërisë, territori i Republikës së Shqipërisë;

për sa i përket Hungarisë, territori i Hungarisë;

b) “shtetas” do të thotë për sa i përket Republikës së Shqipërisë: personat fizikë që në përputhje me legjislacionin në fuqi, konsiderohen si shtetas të Republikës së Shqipërisë.

për sa i përket Hungarisë: personat fizikë që në përputhje me legjislacionin në fuqi, konsiderohen shtetas të Hungarisë;

c) “legjislacion” do të thotë ligjet, rregulloret dhe instrumentet e tjera statutoare në fuqi në lidhje me skemat dhe sistemet e mbrojtjes shoqërore, të mbuluara nga fusha e zbatimit (neni 2) i kësaj Marrëveshjeje;

d) “autoritet kompetent” do të thotë ministrat, ministritë dhe autoritetet e tjera të lidhura me to, përgjegjëse për skemat dhe sistemet e mbrojtjes shoqërore, i rregulluar me legjislacionin, të cilit i referohet neni 2;

e) “institucion” do të thotë institucioni apo autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të mbuluar nga fusha e zbatimit (neni 2) i kësaj Marrëveshjeje;

f) “institucion kompetent” do të thotë institucioni përgjegjës, ku një person është i siguruar në kohën e regjistrimit të kërkesës së tij/saj ose ku personit i lind apo do t'i lindë e drejta, në rast të qëndrimit në territorin e asaj Pale Kontraktuese;

g) “organizata ndërlidhëse” do të thotë organizatat e ngarkuara nga autoritetet kompetente për të mbajtur marrëdhënie të ndërsjella për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;

h) “vend i banimit” do të thotë një vend ku personi i interesuar banon rregullisht në përputhje me rregulloret në fuqi të kësaj Pale Kontraktuese;

i) “vendi i qëndrimit” do të thotë banim i përkohshëm afatshkurtër, kohëzgjatja e të cilit zakonisht lidhet me arritjen e objektivit të qëndrimit të përcaktuar më parë;

j) “periudha sigurimi” do të thotë periudhat e pagesave të kontributeve dhe periudhat e trajtuara



në mënyrë të barabartë me periudhat që konsiderohen të tilla nga legjislacioni i Palëve Kontraktuese;

k) “përfitime në para” do të thotë pensionet dhe përfitimet e tjera në para, si dhe të gjitha rritjet e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palëve Kontraktuese;

l) “përfitime invaliditeti”,

për sa i përket Republikës së Shqipërisë:

- pensionet e plota të invaliditetit për arsye të tjera veç aksidenteve në punë/sëmundjeve profesionale, kur personi bëhet i paaftë për një aktivitet ekonomik apo vuan gjymtime të rënda fizike (duke përfshirë këtu edhe verbërimin);

- pensionet e pjeseshme të invaliditetit për arsye të tjera veç dëmtimeve në punë, kur personi bëhet i paaftë për të kryer profesionin e mëparshëm, por mund të punojë në kushte të veçanta pune.

- për sa i përket Hungarisë, përfitimet për personat me aftësi të ndryshuara për punë;

m) “përfitime në natyrë” do të thotë kujdesi shëndetësor apo kujdesi shëndetësor për dëmtime në rast aksidenti, i cili mundësohet përmes skemës së detyrueshme të sigurimit shëndetësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palëve Kontraktuese;

n) “person në kushte përfitimi” do të thotë një person që plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni nën fushën e zbatimit (neni 2) i kësaj Marrëveshjeje;

o) “person i siguruar” do të thotë një person i specifikuar nga legjislacioni nën fushën e zbatimit (neni 2) të kësaj Marrëveshjeje, si një person i siguruar apo si një person i siguruar më parë;

p) “nëpunës civil” do të thotë:

në Republikën e Shqipërisë, nëpunësit civilë dhe personat ekuivalentë sipas legjislacionit shqiptar;

në Hungari, nëpunësit civilë, punonjësit publikë dhe personat e tjerë të trajtuar si të tillë sipas legjislacionit hungarez.

2. Termat dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë nga legjislacioni në fuqi i Palëve Kontraktuese.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin e mëposhtëm:

për sa i përket Republikës së Shqipërisë,
për ligjet dhe rregulloret në lidhje me:

i) detyrimet e sigurimit dhe pagesën e kontributeve që mbulojnë përfitimet e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor të detyrueshëm; dhe

ii) për sa i përket skemës së sigurimit shoqëror të detyrueshëm:

a) përfitimet në para për sëmundje për personat e punësuar;

b) përfitimet në para për barrë lindje për personat e punësuar apo të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

c) përfitimet në para në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

d) pensionet e pleqërisë, invaliditetit apo familjar për personat e punësuar apo vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

iii) për sa i përket përfitimeve të skemës së sigurimit shëndetësor të detyrueshëm.

për sa i përket Hungarisë,

për ligjet dhe rregulloret në lidhje me:

i) detyrimin për sigurim dhe pagesën e kontributeve që mbulojnë përfitimet e sigurimit shoqëror dhe përfitimet e paguara në rast papunësie;

ii) përfitimet e pensioneve të sigurimit shoqëror;

iii) përfitimet e skemës së sigurimit shëndetësor të detyrueshëm; dhe

iv) përfitimet për personat me aftësi të ndryshuara për punë;

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjithë legjislacionin duke konsoliduar, modifikuar dhe plotësuar legjislacionin e renditur në paragrafin 1.

3. Marrëveshja do të zbatohet, gjithashtu, edhe për ligjet dhe rregulloret e një Pale Kontraktuese, të cilat përcaktojnë skema apo degë të reja të mbrojtjes shoqërore, për të cilat dërgohet më parë një njoftim me shkrim nga autoriteti kompetent i kësaj Pale Kontraktuese tek autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese. Nëse autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese nuk shpreh kundërshtim brenda tre muajve nga data e këtij njoftimi, kjo do të konsiderohet si miratim i zgjerimit të fushës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, legjislacioni i specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk përfshin traktate apo marrëveshje të tjera ndërkombëtare për



mbrojtjen shoqërore të arritura ndërmjet një Pale Kontraktuese dhe një shteti të tretë apo legjislacioni të njohur për zbatimin e tyre specifik.

Neni 3

Hapësira personale

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për:

a) të gjithë personat që mbulohen apo kanë qenë mbuluar nga legjislacioni i njërës apo të dyja Palëve Kontraktuese, të cilëve u referohet neni 2;

b) personat që trashëgojnë të drejtat e tyre nga personat të cilëve u referohet nënseksioni “a”.

Neni 4

Parimi i trajtimit të barabartë

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat që përfshihen në hapësirën e kësaj Marrëveshjeje do të kenë të drejta dhe detyrime të njëjta sipas legjislacionit të një Palë Kontraktuese, si edhe shtetasit e asaj Pale Kontraktuese.

2. Pavarësisht paragrafit 1, dispozitat e mëposhtme do të vazhdojnë të zbatohen:

a) legjislacioni për sigurimet, i përcaktuar në marrëveshje të tjera ndërkombëtare të lidhura midis shteteve të tjera dhe Palëve Kontraktuese;

b) legjislacioni në lidhje me sigurimin e personave të punësuar në misione zyrtare ose nga agjentë të misioneve të tilla të një shteti të tretë të secilës prej Palëve Kontraktuese;

c) legjislacioni i të dyja Palëve Kontraktuese për bashkëpunimin midis personave të siguruar dhe personave të punësuar në agjencitë e institucioneve dhe shoqatave, si dhe të fushës së arbitrazhit në lidhje me mbrojtjen shoqërore.

Neni 5

Eksportimi i përfitimeve

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, pensionet, pagesat dhe përfitimet e tjera në para, për të cilat e drejta e përfitimit lind sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese, nuk do të reduktohen, ndryshohen, pezullohen apo tërhiqen për arsyen se personit që i ka lindur e drejta e përfitimit ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Përfitimet e parashikuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje do t'u paguhen shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese sipas të njëjtave kushteve që

zbatohen për shtetasit e Palës së parë Kontraktuese, madje edhe në rastet kur këta persona qëndrojnë në një shtet të tretë.

Neni 6

Shmangia e mbivendosjes së përfitimeve

1. Kjo Marrëveshje nuk mund të sigurojë ose ruajë të drejtën për dy ose më shumë përfitime që mbulojnë të njëjtën degë sigurimi, të dhëna për të njëjtën periudhë sigurimi.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të zbatohen për përfitimet në lidhje me invaliditetin, pleqërinë, humbjen e mbajtësit të familjes, aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale, të cilat paguhen nga institucionet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 21 dhe nenit 25.

3. Legjislacioni i një Pale Kontraktuese që përjashton apo kufizon të drejtën për përfitime ose përfitimet në rast të mbivendosjes të së drejtës, përfitimeve apo të ardhurave, do të zbatohet *mutatis mutandis* sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Asimilimi i fakteve

Rastet e parashikuara nga legjislacioni i një Pale Kontraktuese, që ndikojnë në masën e përfitimeve në para apo në dhënien e së drejtës për përfitime në para, të cilat ndodhin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të llogariten sikur ato të kenë ndodhur në territorin e Palës së parë Kontraktuese.

PJESA II

**DISPOZITA NË LIDHJE ME
LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM**

Neni 8

Dispozita të përgjithshme

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga rregullat e veçanta, të parashikuara në nenet 9, 10, 11 dhe 12 të kësaj Marrëveshjeje, një person, që kryen një aktivitet fitimprurës në territorin e një Pale Kontraktuese, do të jetë subjekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese, pavarësisht shtetit në të cilin punëdhënësi ka zyrat e tij të regjistruara apo vendbanimit të të punësuarit.



2. Një person, i cili kryen një aktivitet si person i punësuar në territorin e një Pale Kontraktuese, si dhe kryen një aktivitet si person i vetëpunësuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të jetë subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ai/ajo kryen aktivitetin e tij/saj si person i punësuar.

3. Personi, i cili kryen aktivitete të njëkohshme si i vetëpunësuar në territorin e të dyja Palëve Kontraktuese, do të jetë subjekt vetëm i legjislacionit të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ai/ajo ka vendbanimin e tij/saj.

4. Personi, i cili kryen njëkohësisht aktivitete fitimprurëse si person i punësuar në territoret e të dyja Palëve Kontraktuese, do të jetë subjekt vetëm i legjislacionit të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ai/ajo ka vendin e banimit të tij/ saj, duke përjashtuar rastet e specifikuar në nenin 9.

Neni 9

Dispozita të veçanta

Nëse një i punësuar i një punëdhënësi me seli në territorin e një Pale Kontraktuese, dërgohet nga punëdhënësi i tij/saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për të punuar për llogari të tij, ai/ajo do të mbetet subjekt i legjislacionit të Palës së mëparshme Kontraktuese, sikur të vazhdonte të ishte i punësuar në këtë territor, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e punës së tij/saj të mos i kalojë 24 muaj dhe që ai/ajo të mos dërgohet për të zëvendësuar një person tjetër, periudha e transferimit të të cilit ka përfunduar.

Neni 10

Nëpunësit civilë dhe personeli që shërben në bordin e anijeve apo mjeteve të tjera lundruese

1. Nëpunësit civilë të një Pale Kontraktuese, të dërguar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për të kryer aktivitetin e tyre atje, do të mbeten subjekt i legjislacionit të Palës së mëparshme Kontraktuese.

2. Për anëtarët në bordin e anijeve që mbajnë flamurin e një Pale Kontraktuese, duhet të zbatohet legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese me flamurin e të cilit lundron anija. Kjo dispozitë do të zbatohet, nëse është e nevojshme, edhe për personelin e punësuar në bordet e mjeteve të tjera lundruese.

Neni 11

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Për sa i përket zbatimit të legjislacionit, të cilit i referohet neni 2, kjo Marrëveshje nuk cenon zbatueshmërinë e dispozitave të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, 18 prill 1961 dhe të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të datë 24 prill 1963.

Neni 12

Përjashtime nga dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese apo organizatat e tjera të përcaktuara prej tyre, me kërkesë të përbashkët të punëdhënësit dhe punëmarrësit apo të personit të vetëpunësuar, mund të parashikojnë përjashtime të mëtijshme nga dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që personi i interesuar të vazhdojë të jetë i mbuluar nga legjislacioni i një Pale Kontraktuese. Në rast të ndonjë përjashtimi duhet të merren parasysh aspektet dhe rrethanat e punësimit.

Neni 13

Komunikimi dhe vërtetimi i mbulimit

Kur legjislacioni i një Pale Kontraktuese është i zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Pale, organizata ndërlidhëse e asaj Pale Kontraktuese duhet të lëshojë me kërkesë të përbashkët të punëdhënësit dhe të të punësuarit ose me kërkesë të personit të vetëpunësuar, një vërtetim, ku deklorohet se punonjësi apo personi i vetëpunësuar është subjekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese dhe ku tregohet kohëzgjatja për të cilën ky vërtetim është i vlefshëm. Ky vërtetim vërteton se i punësuar apo i vetëpunësuar është i çliruar nga legjislacioni për mbulimin e detyrueshëm të Palës tjetër Kontraktuese.

I punësuar apo personi i vetëpunësuar në fjalë, si dhe punëdhënësi i të punësuarit dhe organizata ndërlidhëse e Palës tjetër Kontraktuese kanë të drejtë të marrin një kopje.



PJESA III
DISPOZITA TË VEÇANTA

KAPITULLI 1
PËR FITIMET NË NATYRË DHE PARA
PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE

Neni 14

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Për qëllimet e marrjes, ruajtjes dhe rikthimit të të drejtave për përfitime në para në fushën e sigurimit për sëmundje dhe barrëlindje, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese do të bashkohen, nëse këto periudha nuk janë të mbivendosura.

Neni 15

Përfitimet në natyrë

Një person, i cili është i siguruar për përfitime në natyrë sipas skemës së sigurimit shëndetësor nga institucioni kompetent i një Pale Kontraktuese dhe i cili:

a) ka nevojë urgjente për kujdes mjekësor gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe që nuk ka udhëtuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, me qëllim për të marrë trajtim mjekësor; ose

b) ka marrë ose merr miratimin e autoritetit kompetent ose institucionit kompetent për të udhëtuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, me qëllim për të marrë trajtim mjekësor në përputhje me kushtet mjekësore, do të ketë të drejtë për përfitime në natyrë, me shpenzimet e institucionit kompetent, nga institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e kësaj Pale Kontraktuese, sikur ky person të ishte i siguruar sipas legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese. Në këto raste, autoriteti kompetent duhet të lëshojë një certifikatë me kërkesën e personit të interesuar, përpara se personi i interesuar të largohet nga territori i Palës Kontraktuese ku ai/ajo është i/e siguruar. Kujdesi urgjent mjekësor do të kuptohet si kujdes që nuk mund të shtyhet deri në kohën kur personi të kthehet në vendbanimin e tij.

Neni 16

Përfitimet në para për sëmundje dhe barrëlindje

1. Në mënyrë që të tërheqë përfitime në para, personi i interesuar, brenda një kohe të arsyeshme

duhet të njoftojë për paaftësinë e tij/saj për punë institucionin e vendit të qëndrimit, duke dorëzuar një raport paaftësie për punë të lëshuar nga mjeku që po trajton këtë person. Institucioni i vendit të qëndrimit duhet të lëshojë formularin përkatës dhe duhet t'ia dërgojë atë menjëherë institucionit kompetent.

2. Përfitimet në para duhet të paguhen në pajtim me legjislacionin në fuqi të institucionit kompetent në fjalë.

Neni 17

Vendosja e së drejtës së pensionistëve

1. Një person, i cili merr pension nga administratat e sigurimit të pensionit të të dyja Palëve Kontraktuese, do të ketë të drejtën për përfitime në natyrë të sigurimit shëndetësor në vendbanimin e tij/saj, me shpenzimet e institucionit të vendbanimit të pensionistit.

2. Dispozitat e parashtruara në paragrafin 1 mund të mos zbatohen kur personi i interesuar është i siguruar për punësim apo përfitime të sigurimit shëndetësor në vendin e tij të banimit, në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese në vendin e banimit.

Neni 18

Institucioni i vendit të banimit dhe i vendit të qëndrimit

Përfitimet në natyrë, të cilave u referohen nenet 15 dhe 17 të kësaj Marrëveshjeje, do të jepen nga institucioni i vendbanimit ose nga institucioni i vendqëndrimit:

- në Republikën e Shqipërisë: organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm;
- në Hungari: organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm.

Neni 19

Rimbursimi i kostove në lidhje me përfitimet në natyrë

Institucioni kompetent do të rimbursojë institucionin e Palës tjetër Kontraktuese për shpenzimet e bëra në lidhje me dispozitat e përfitimeve në natyrë, me përjashtim të kostove administrative.



KAPITULLI 2

AKSIDENTET NË PUNË DHE
SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 20

Përcaktimi i përfitimeve

1. Një person i siguruar, i cili gjatë periudhës së sigurimit, ka pësuar një aksident në punë ose vuan nga një sëmundje profesionale, mund të ketë të drejtën për përfitime në natyrë në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese ku ai/ajo është i/e siguruar. Personi i interesuar do të marrë përfitime në natyrë, kur ai/ajo qëndron apo banon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Përfitimet në natyrë jepen me shpenzime të institucionit kompetent, nga institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit në përputhje me legjislacionin që ai zbaton; gjithsesi, periudha gjatë së cilës mund të jepen përfitimet në natyrë përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese kompetente.

2. Përfitimet në para për aksidentet në punë do të jepen nga institucioni kompetent i Palës Kontraktuese, ku personi i interesuar ka qenë i siguruar në kohën kur ka ndodhur aksidenti në punë, sipas legjislacionit të tij.

3. Nëse legjislacioni i një Pale Kontraktuese parashikon se për të përcaktuar masën e dëmtimit shëndetësor apo masën e humbjes së aftësisë për punë si pasojë e një aksidenti në punë apo një sëmundjeje profesionale ose për të përcaktuar të drejtën për përfitim në natyrë apo në para, do të merret parasysh një aksident i mëparshëm në punë apo një sëmundje profesionale dhe po ashtu do të merret parasysh një aksident në punë dhe një sëmundje profesionale sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

4. Institucioni kompetent për përfitimet që do të jepen në lidhje me aksidentin në punë apo sëmundjen profesionale, do ta përcaktojë përfitimin në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas masës së dëmtimit të shëndetit apo shkallës së humbjes të aftësisë për punë për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale.

5. Nëse aksidenti në punë ndodh rrugës për në punë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të konsiderohet se ka ndodhur në territorin e asaj Pale Kontraktuese, ku personi i interesuar i është i siguruar në momentin e aksidentit në punë.

Neni 21

**Marrja parasysh e profesioneve të rrezikshme
për shëndetin**

1. Për sa i përket së drejtës për përfitime që do të jepen mbi bazën e një sëmundjeje profesionale, institucioni kompetent i një Pale Kontraktuese duhet, gjithashtu, të marrë parasysh edhe ato sëmundje të rrezikshme për shëndetin, të cilat në përputhje me legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese dhe sipas karakteristikave të tyre mund të konsiderohen si shkaqet e sëmundjeve në fjalë. Nëse ekziston e drejta e përfitimit sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese, me përjashtim të pensionit dhe pensionit vjetor për aksident, përfitimet në natyrë dhe para do të jepen nga institucioni kompetent në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës është vendi i banimit të personit që e ka fituar këtë të drejtë. Nëse sipas legjislacionit në fuqi të një Pale Kontraktuese ekziston e drejta për pension apo pension vjetor për aksident, institucioni kompetent duhet të paguajë vetëm atë pjesë të përfitimit, që korrespondon me raportin e periudhës gjatë së cilës është kryer profesioni i rrezikshëm për shëndetin, në përputhje me legjislacionin e kësaj Pale Kontraktuese, me periudhën gjatë së cilës është kryer profesioni i rrezikshëm për shëndetin, në përputhje me legjislacionin e të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Në rast të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të personit, për të rivlerësuar një përfitim për shkak të përkeqësimit të gjendjes, duhet të zbatohen dispozitat e parashtruara në paragrafin 1. Kur ky përkeqësim shëndetësor ndodh si pasojë e një profesioni tjetër të rrezikshëm për shëndetin, e drejta për përfitim, lidhur me përkeqësimin e shëndetit, do të konsiderohet se ekziston në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese, ku është ushtruar profesioni i rrezikshëm për shëndetin. Institucioni kompetent i Palës së parë Kontraktuese duhet, gjithashtu, të paguajë përfitimin, siç është përcaktuar më parë në lidhje me sëmundjet profesionale në këto raste, ndërsa institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese do të japë diferencën e përfitimit, i cili mund të përcaktohet midis përfitimit për shkak të përkeqësimit të një sëmundjeje ekzistuese kundrejt përfitimit për shkak të gjendjes para përkeqësimit.



3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 do të zbatohen edhe për përfitimet që do t'u paguhen personave që kanë humbur mbajtësin e familjes.

Neni 22

Metoda e pagesave të përfitimeve në para

1. Institucioni kompetent do të paguajë përfitime në para në përputhje me legjislacionin në fuqi që ai administron.

2. Kur legjislacioni i një Pale Kontraktuese parashikon që shuma e përfitimeve në para do të varet nga numri i anëtarëve të familjes, institucioni kompetent duhet, gjithashtu, të marrë parasysh edhe anëtarët e familjes që banojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 23

Rimbursimi i kostove që lidhen me përfitime në natyrë

Institucioni kompetent do të rimbursojë institucionin e Palës tjetër Kontraktuese për shpenzimet e bëra në lidhje me dhënien e përfitimeve në natyrë, me përjashtim të shpenzimeve administrative.

KAPITULLI 3 PENSIONET

Neni 24

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Kur legjislacioni i një Pale Kontraktuese e kushtëzon marrjen, ruajtjen apo rishikimin e së drejtës për një pension me plotësimin e periudhave të sigurimit dhe në rast se në bazë të legjislacionit të një Pale Kontraktuese nuk përmbushen kriteret e së drejtës për një pension, institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese do të marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, sikur këto periudha të ishin plotësuara sipas legjislacionit që ai administron, me kusht që këto periudha sigurimi të mos mbivendosen.

2. Kur legjislacioni i Republikës së Shqipërisë e kushtëzon dhënien e pensioneve të pleqërisë, pensionit familjar dhe të invaliditetit me plotësimin e periudhave të sigurimit në një profesion të dhënë, për të pranuar të drejtën për këto pensione, do të bashkohen vetëm periudhat e sigurimit të plotësuara apo të njohura si ekuivalente në të njëjtin profesion në Hungari.

Kur legjislacioni i Republikës së Shqipërisë e kushtëzon dhënien e pensioneve të pleqërisë, pensionit familjar dhe invaliditetit me plotësimin e periudhave të sigurimit në një profesion të dhënë dhe kur këto periudha nuk rezultojnë në dhënien e së drejtës për këto pensione, periudhat e lartpërmendura do të konsiderohen të vlefshme për përcaktimin e pensioneve të pleqërisë, familjarë dhe të invaliditetit, të mundësuar nga skema e përgjithshme për personat e punësuar.

3. Shuma e periudhave të sigurimit që do të merret në konsideratë duhet të përcaktohet në përputhje me legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese, sipas të cilit janë plotësuar këto periudha sigurimi.

4. Kur e drejta për një pension ekziston sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese, edhe pa zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, pensioni do të përcaktohet nga institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese në bazë të periudhave të sigurimit që do të merren parasysh sipas dispozitave të legjislacionit që ai administron.

Neni 25

Bashkimi i periudhave të fituara sipas legjislacionit të një shteti të tretë

1. Nëse personi i interesuar nuk plotëson kushtet për një pension në bazë të bashkimit të periudhave të sigurimit, të fituara sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese, e drejta e këtij personi për këtë pension do të përcaktohet duke mbledhur këto periudha sigurimi me periudhat e grumbulluara sipas legjislacionit të një shteti të tretë, me të cilin të dyja Palët Kontraktuese janë lidhur përmes instrumenteve ligjore të mbrojtjes shoqërore që mundësojnë bashkimin e periudhave.

2. Në rast se vetëm njëra nga Palët Kontraktuese ka marrëveshje me një shtet të tretë, kjo Palë Kontraktuese do të bashkojë periudhat e sigurimit sipas legjislacionit të shtetit të tretë, përveç rasteve kur marrëveshja e lidhur me këtë shtet të tretë përcakton ndryshe.

3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk do të zbatohet për periudhat e sigurimit të fituara sipas legjislacionit të një shteti të tretë me të cilin Pala Kontraktuese ka arritur marrëveshje bazuar në parimet e territorialitetit.



Neni 26

Përcaktimi i pensioneve proporcionale

1. Kur një person ka të drejtë për pension në përputhje me legjislacionin e një prej Palëve Kontraktuese vetëm nëse bashkohen periudhat e sigurimit të tij, institucioni kompetent do të llogarisë shumën e pensionit që duhet të paguajë ky institucion, nëse për përcaktimin e pensionit janë marrë parasysh të gjitha periudhat e sigurimit të fituara sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Institucioni shqiptar do të paguajë vetëm pjesën e pensionit të llogaritur sipas paragrafit 1 që korrespondon me raportin e periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të tij me periudhën e sigurimit të kërkuar për pensionin e plotë të pleqërisë dhe invaliditetit sipas legjislacionit të tij.

3. Institucioni hungarez do të paguajë vetëm pjesën e pensionit të llogaritur sipas paragrafit 1 që korrespondon me raportin e periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të tij me totalin e periudhës së sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 27

Metoda e llogaritjes së pensioneve

Kur sipas legjislacionit të njëres prej Palëve Kontraktuese pensionet llogariten në bazë të të ardhurave apo kontributeve të paguara, institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese do të marrë parasysh ekskluzivisht të ardhurat apo kontributet e paguara sipas legjislacionit që ai administron.

Neni 28

Periudhat e sigurimit më të shkurtra se një vit

Kur totali i periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese nuk arrin 365 ditë, nëse nuk ekziston e drejta për pensione vetëm në bazë të kësaj periudhe sigurimi, institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese nuk do të japë asnjë pension për periudha më të shkurtra se 365 ditë. Për qëllimet e plotësimit dhe llogaritjes, këto periudha sigurimi do të merren parasysh nga Pala tjetër Kontraktuese, sikur ato të jenë plotësuar sipas legjislacionit të saj.

KAPITULLI 4

PËRFITIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË NDRYSHUARA PËR PUNË SIPAS LEGJISLACIONIT HUNGAREZ

Neni 29

Metoda e llogaritjes së përfitimeve

1. Kur një e drejtë për përfitim mund të vendoset me periudhat e mbulimit të plotësuar vetëm sipas ligjeve hungareze, përfitimet do të llogariten si më poshtë:

a) Institucioni kompetent hungarez do të llogarisë përfitimin e pagueshëm sipas ligjeve hungareze dhe të zbrësë nga kjo shumë çdo shumë të pensioneve të pleqërisë apo invaliditetit të dhëna nga institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese; dhe

b) Institucioni kompetent hungarez do të llogarisë përfitimin e pagueshëm sipas ligjeve hungareze të shumëzuar me raportin e periudhave të mbulimit, të plotësuar sipas ligjeve hungareze me periudhat e mbulimit të plotësuar sipas ligjeve të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Institucioni kompetent hungarez do të paguajë shumën më të lartë të shumave të llogaritura sipas paragrafëve 1/“a” dhe “b”.

3. Kur e drejta për një përfitim vendoset ekskluzivisht duke marrë parasysh periudhat e mbulimit, të plotësuar sipas ligjeve të të dyja Palëve Kontraktuese, institucioni kompetent hungarez do të llogarisë shumën teorike të përfitimit, e cila mund të jepet nëse të gjitha periudhat e mbulimit sipas ligjeve të të dyja Palëve Kontraktuese plotësohen sipas ligjeve të Hungarisë dhe duke shumëzuar rezultatin nga raporti i periudhave të mbulimit, të plotësuar sipas ligjeve hungareze, me totalin e periudhave të mbulimit të plotësuar sipas ligjeve të të dyja Palëve Kontraktuese. Institucioni kompetent hungarez do të paguajë vetëm pjesën e përfitimit të llogaritur në këtë mënyrë.

4. Çdo përfitim i fituar sipas paragrafit 1/b ose paragrafit 3 të këtij neni nuk mund të zbritet nga shuma e ndonjë përfitimi të dhënë nga institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

5. Kur periudhat totale të mbulimit, të plotësuar sipas ligjeve të Hungarisë, nuk i kalojnë 365 ditë, institucioni kompetent hungarez nuk do të japë përfitim sipas hapësirës së këtij neni.

6. E drejta për përfitim rehabilitimi mund të vendoset ekskluzivisht në rastin e rezidencës hungareze.

PJESA IV DISPOZITA TË PËRZIERA

Neni 30

Organizatave ndërlidhëse

1. Autoritetet Kompetente duhet të përcaktojnë organizatat përkatëse ndërlidhëse dhe të informojnë njëri-tjetrin për këtë.

2. Organizatat ndërlidhëse do të mundësojnë komunikimin ndërmjet institucioneve të Palëve Kontraktuese dhe do të asistojnë njëri-tjetrin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Përfaqësuesit e organizatave ndërlidhëse do të takohen në mënyrë alternative në territorin e të dyja Palëve Kontraktuese për të diskutuar çështjet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 31

Formularët dhe procedurat e detajuara

1. Organizatat ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese do të bien bashkërisht dakord për formularët dhe procedurat e detajuara të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes.

2. Institucionet ose organizatat ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese do të pranojnë një kërkesë për përfitim ose certifikatë apo kërkesë tjetër, me kusht që ajo të dorëzohet në formën e miratuar për këtë qëllim.

Neni 32

Pagesa e përfitimeve në para

1. Palët Kontraktuese do t'i paguajnë përfituesit përfitimet në para në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Institucionet e Palëve Kontraktuese do të paguajnë përfitimet e tyre në para pa asnjë zbritje për shpenzimet e tyre administrative.

Neni 33

Shkëmbimi i të dhënave statistikore

Organizatave ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë, çdo 31 dhjetor, statistikave vjetore mbi numrin e vërtetimeve të lëshuara dhe mbi pagesat e dhëna për përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje. Këto statistika do të përfshijnë numrin e përfituesve dhe shumën totale të përfitimeve, të identifikuar sipas llojit të përfitimit

të paguar sipas kësaj Marrëveshjeje. Këto statistika duhet të jepen në një formë të miratuar nga organizatat ndërlidhëse.

Neni 34

Bashkëpunimi administrativ

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese do të asistojnë njëri-tjetrin për sa i përket përcaktimit për të drejta apo pagesë për përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje, si edhe do të vepronin për zbatimin e legjislacionit të tyre. Asistenca së cilës i referohet ky nen do të sigurohet pa rimbursim reciprok të kostove.

2. Kur legjislacioni i një Pale Kontraktuese përcakton se një dokument i dorëzuar në autoritetin kompetent të asaj Pale Kontraktuese duhet të përjashtohet, plotësisht apo pjesërisht, nga tarifat apo taksat, duke përfshirë tarifat konsullore dhe administrative, ky përjashtim do të zbatohet edhe për dokumentet korresponduese që dorëzohen në autoritetin dhe institucionin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

3. Dokumentet dhe vërtetimet që duhet të përgatiten për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nuk kanë nevojë për vërtetim nga zyrtarë diplomatike dhe konsullore. Kopjet e dokumenteve që vërtetohen si kopje të vërteta dhe të sakta nga një institucion apo autoritet kompetent i një Pale Kontraktuese do të pranohen si të tilla, pa vërtetime të mëtejshme edhe nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

4. Një kërkesë apo dokument nuk mund të refuzohet nga një autoritet apo institucion kompetent i një Pale Kontraktuese vetëm për arsye se është në gjuhën zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 35

Informacioni mjekësor dhe kontrollet mjekësore

1. Kërkesa për informacion dhe dokumentacion dhe përcjellja e tyre do të bëhet nëpërmjet organizatave ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese.

2. Nëse institucionet e një Pale Kontraktuese kërkojnë që një kërkues apo përfitues, që banon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësor, institucionet e Palës së fundit Kontraktuese, me kërkesë të Palës



së parë Kontraktuese, do të marrin masat për kryerjen e këtij kontrolli. Nëse ky kontroll është ekskluzivisht në dobi të institucionit që e kërkon atë, ky institucion do të rimburojë institucionin e Palës tjetër Kontraktuese për kostot e kontrollit. Gjithsesi, nëse kontrolli mjekësor është në dobi të të dyja institucioneve, nuk do të ketë rimbursim të kostos.

Neni 36

Trajtimi i barabartë i kërkesave

1. Kur një kërkesë për përfitim sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese dorëzohet në një institucion të Palës tjetër Kontraktuese, që ka të drejtë të pranojë kërkesa për dhënie e një përfitimi sipas legjislacionit të zbatueshëm, kjo kërkesë do të trajtohet sikur të jetë dorëzuar tek institucioni i Palës së parë Kontraktuese. Kjo dispozitë, kur është e përshtatshme, do të zbatohet për kërkesat e tjera, si dhe për deklaratat dhe mjetet ligjore.

2. Autoriteti apo organizata e një Pale Kontraktuese në të cilën është dorëzuar një kërkesë, deklaratë apo mjet ligjor, duhet t'ia dërgojë atë pa vonesë autoritetit apo organizatës kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, duke përcaktuar datën e marrjes.

3. Një kërkesë për marrjen e një përfitimi sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese do të cilësohet si kërkesë për marrjen e një përfitimi në përputhje me legjislacionin e Palës tjetër Kontraktuese. Kjo dispozitë nuk do të aplikohet nëse kërkuesi, kërkon shprehimisht që të shtyhet përcaktimi i së drejtës për një përfitim në para sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 37

Shqyrtimi i një kërkesë

1. Kur institucioni i një Pale Kontraktuese merr kërkesën e një personi, e cila u referohet periudhave të mbulimit sipas legjislacionit të Palës tjetër apo të të dyja Palëve Kontraktuese, ky institucion duhet ta dërgojë kërkesën nëpërmjet organizatës ndërlidhëse tek institucioni i Palës tjetër Kontraktuese, duke treguar datën e marrjes së kësaj kërkesë.

Së bashku me kërkesën, ai gjithashtu do t'i përcjellë institutit të Palës tjetër Kontraktuese:

a) çdo dokument të disponueshëm që për institucionin e Palës tjetër Kontraktuese mund të jetë i nevojshëm për të përcaktuar të drejtën e

kërkuarit për përfitim;

b) formularët që në veçanti tregojnë periudhat e mbulimit të plotësuara sipas legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese;

c) dhe, së fundi, një kopje të vendimit të tij për përfitimin, nëse ai është pranuar.

2. Institucioni i Palës tjetër Kontraktuese përcakton më pas të drejtën e kërkuarit dhe i njofton vendimin e tij organizatës ndërlidhëse kompetente të Palës së parë Kontraktuese.

Së bashku me vendimin e tij, nëse kërkohet apo është e nevojshme, ai duhet t'i përcjellë institucionit të Palës së parë Kontraktuese:

a) çdo dokument të disponueshëm që për institucionin e Palës së parë Kontraktuese mund të jetë i nevojshëm për të përcaktuar të drejtën e kërkuarit për përfitim;

b) formularët, që në veçanti tregojnë periudhat e mbulimit të plotësuara sipas legjislacionit që zbaton.

3. Institucioni kompetent i Palës Kontraktuese, ku është regjistruar një kërkesë për përfitime, do të verifikojë informacionin që i përket kërkuarit dhe anëtarëve të familjes së tij. Lloji i informacionit që do të verifikohet, duhet të miratohet nga organizatat ndërlidhëse të të dyja Palëve Koorinuere.

Neni 38

Vendimet e zbatueshme dhe njohja e vërtetimeve

1. Vendimet e zbatueshme të gjykatave të një Pale Kontraktuese, që kanë lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje ose vendimet për zbatim të institucioneve apo autoriteteve në lidhje me kontributet e sigurimit shoqëror apo kërkesa të tjera do të njihen nga gjykatat, autoritetet dhe organizatat e tjera të Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e saj.

2. Njohja e dokumenteve mund të refuzohet vetëm në rast se ato janë në kundërshtim me legjislacionin apo me rendin publik të asaj Pale Kontraktuese, ku duhet të njihet një gjykim apo vërtetim.

3. Vendimet e njohura në fuqi apo vërtetimet e parashikuara në paragrafin 1, duhet të zbatohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Duhet të kryhet një procedurë detyruese, duke zbatuar legjislacionin përkatës në fuqi të asaj Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës do të



zbatohen vendimet apo vërtetimet në fjalë. Në një kopje autentike të këtyre dokumenteve, duhet të deklarohet konfirmimi se këto vendime apo vërtetime janë detyruese (klauzolë detyruese).

4. Kërkesat në lidhje me kontributet e vonuara të parashtruara nga institucioni në territorin e një Pale Kontraktuese duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit, falimentimit, shlyerjes, likuidimit dhe procedurave përfundimtare të shlyerjes, që do të zbatohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese njëjloj si kërkesat korresponduese të parashtruara në territorin e Palës së interesuar Kontraktuese.

Neni 39

Dërgimi dhe gjuhët e komunikimit

1. Institucionet, autoritetet dhe gjykatat e Palëve Kontraktuese, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me fushën e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin dhe me personat e interesuar apo me përfaqësuesit e tyre në secilën gjuhë zyrtare të Palëve Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e tyre.

2. Institucionet, autoritetet dhe gjykatat e Palëve Kontraktuese nuk mund të refuzojnë kërkesat apo vërtetimet që u janë dërguar për arsye se ato janë të shkruara në një gjuhë zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Gjykimet dhe vendimet mund të dërgohen me postë rekomande me kërkesën për konfirmim marrjeje, si dhe dokumentet e tjera me postë të regjistruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë te personi që po qëndron në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 40

Mbrojtja e të dhënave

1. Kur bazuar në këtë Marrëveshjeje dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të të dyja Palëve Kontraktuese, duhet të transferohen të dhëna personale që përfshijnë të dhëna shëndetësore të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e Palëve Kontraktuese do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe legjislacionit që mbulohet nga hapësira e saj, njëra Palë Kontraktuese mund t'i dërgojë të dhëna institucioneve të Palës tjetër Kontraktuese. Për këto

qëllim, Pala Kontraktuese marrëse mund t'i përpunojë dhe përdorë këto të dhëna. Në të gjitha rastet e tjera, të dhënat mund t'u dërgohen institucioneve të tjera ekskluzivisht, me miratimin paraprak të institucioneve transmetuese dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi për këto institucione.

b) Institucioni që merr këto të dhëna duhet, që me kërkesë dhe në raste individuale, të informojë institucionin që jep të dhënat për qëllimin e përdorimit të të dhënave të ekspozuara dhe për rezultatin e këtij përdorimi.

c) Institucioni që jep këto të dhëna duhet të sigurojë se të dhënat e ekspozuara janë të sakta dhe se janë të nevojshme duke u nisur nga qëllimi i ekspozimit të tyre. Në të njëjtën kohë, duhet të merren në konsideratë të gjitha kufizimet për ekspozimin e të dhënave, sipas legjislacionit kombëtar të asaj Pale Kontraktuese. Nëse rezulton se të dhënat e transferuara janë jokorrekte ose mund të mos jenë transferuar sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese që mundëson këto të dhëna, institucioni marrës do të njoftohet pa asnjë vonesë dhe do të korrigjojë ose fshijë këto të dhëna, sipas rastit.

d) Personit të interesuar, me kërkesën e tij/saj, do t'i jepet informacion për të dhënat rreth tij/saj, rreth burimit të të dhënave dhe qëllimit të përdorimit të këtyre të dhënave, për bazën ligjore dhe kohëzgjatjen e përdorimit të këtyre të dhënave, emrin dhe adresën e përpunuesit të të dhënave dhe aktivitetet në lidhje me kontrollin e të dhënave, si dhe mbi atë që ka marrë apo do të marrë këto të dhëna. Nga ana tjetër, të drejtat e personit të interesuar për t'u informuar rreth të dhënave që mbahen për të, do të jenë subjekt i legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese, institucionit të së cilës i është kërkuar të mundësojë informacionin.

e) Të dhënat personale të marra do të fshihen pa vonesë, kur sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese që merr këto të dhëna, ato bëhen të pavlefshme për qëllimin e këtij ekspozimi.

f) Dërgimi dhe marrja e të dhënave personale do të regjistrohen si nga institucioni dërgues, po ashtu edhe nga ai marrës.

g) Si institucionet dërguese ashtu edhe ato marrëse do të sigurojnë mbrojtjen efektive të të dhënave personale, në përputhje me legjislacionet kombëtare përkatëse, kundrejt shkeljeve, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek aksesit i



paautorizuar, ndryshime të paligjshme dhe ekspozimi i paautorizuar.

h) Me kërkesë të personit të përfshirë, si Pala Kontraktuese marrëse ashtu edhe ajo dërguese duhet të korrigjohet të dhënat e pasakta që trajtohen nga ato ose të fshihen apo të mohojnë aksesin ndaj të dhënave të trajtuara në mënyrë të paligjshme. Pala tjetër Kontraktuese duhet të informohet menjëherë për korrigjime, fshirje apo mohim të aksesit.

i) Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë se zbatimi i kërkesave për mbrojtjen e të dhënave të vendosura në këtë Marrëveshje monitorohet nga organizata të pavarura nga institucionet në përputhje me legjislacionet përkatëse të Palëve Kontraktuese. Në rast të shkeljes së të drejtave që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, personi i prekur ka të drejtën e një kompensimi ligjor, duke përfshirë edhe kompensimin si pasojë e një vendimi gjyqësor, në përputhje me legjislacionet përkatëse kombëtare të Palëve Kontraktuese.

j) Nëse institucioni i një Pale Kontraktuese ka zbuluar të dhëna personale sipas kësaj Marrëveshjeje, institucionet marrëse të Palës tjetër Kontraktuese, brenda përgjegjësisë së tyre, sipas legjislacionit kombëtar në fuqi, nuk mund të kundërshtojnë personin e interesuar se këto të dhëna janë të pasakta. Paga e kompensimit për dëmet për shkak të të dhënave të pasakta do të rregullohet nga legjislacioni i Palës Kontraktuese, ku ka ndodhur shkelja.

2. Dispozitat e vendosura në paragrafin 1 të këtij neni, gjithashtu, do të zbatohen, sipas rastit, për sekretet tregtare dhe të korporatave.

Neni 41

Monedhat dhe kursi i këmbimit

1. Institucionet që duhet të japin përfitime për arsye të kësaj Marrëveshjeje do ta bëjnë këtë në monedhën zyrtare të vendit të tyre. Kur, sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese, personi i interesuar vendos që përfitimet t'i paguhen në një monedhë të ndryshme nga ajo kombëtare e Palës Kontraktuese që jep përfitimin, shpenzimet e bëra dhe risku i këmbimit do të përballohen nga vetë personi. Shpenzimet që kanë të bëjnë me transferimin e përfitimeve jashtë vendit do të rregullohen nga legjislacioni i Palës Kontraktuese që jep përfitimin.

2. Kur institucioni i një Pale Kontraktuese duhet t'i bëjë pagesa institucionit të Palës tjetër Kontraktuese, ato duhet të kryhen në monedhën zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese, me kusht që të jenë të këmbyeshme. Ndryshe pagesat duhet të kryhen në euro.

3. Nëse një Palë Kontraktuese miraton rregullore të re mbi kontrollin e këmbimit të huaj, të dyja Palët Kontraktuese duhet të marrin masa pa asnjë vonesë për të siguruar transfertën e shumave nga njëra prej Palëve sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

4. Pagesat e bëra sipas qëllimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të kryhen në bazën e rregullave që janë në fuqi në territorin e Palës Kontraktuese që paguan përfitimin në datën e pagesave të tilla.

Neni 42

Detyrimi i shlyerjes

Kur instituti i një Pale Kontraktuese ka bërë pagesa të gabuara apo të paligjshme të një përfitimi në para, shuma e paguar duhet të zbritet nga përfitimi i të njëjtit lloj, të paguar sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, në favor të institucionit të interesuar.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet nëpërmjet konsultimit midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Nëse autoritetet kompetente nuk mund të arrijnë një zgjidhje, ato, në përputhje me ligjin ndërkombëtar, mund t'i drejtohen arbitrazhit.

Neni 44

Procedura administrative shtesë

1. Procedurat administrative shtesë, të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, parashtrihen në shtojcën "Procedurat administrative" të kësaj Marrëveshjeje.

2. Dispozitat e parashtruara në shtojcën "Procedurat administrative" janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe kanë të njëjtën fuqi ligjore.



PJESA V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 45

E drejta e fituar në bazë të kësaj Marrëveshjeje

1. Kjo Marrëveshje do të përcaktojë të drejtën për përfitime nga data e hyrjes në fuqi të saj.

2. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, duhet të merren parasysh rrethanat domethënëse ligjore, që ekzistojnë sipas legjislacionit në fuqi të të dyja Palëve Kontraktuese përpara se kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

3. Vendimet e marra për rastet individuale përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nuk do ta pengojnë zbatimin e saj.

4. Pensionet që janë caktuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mund të ripërcaktohen, me kërkesë, brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, nëse ndodh një ndryshim vetëm për shkak të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur nuk është e mundur të jepet një përfitim për pension, bazuar në rivlerësimin e pensionit, të cilit i referohet paragrafi 4, apo nëse shumat e tij janë më të vogla se shumata e fundit e paguar përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, pensioni do të paguhet në mënyrën që është përcaktuar më parë.

Neni 46

**Detyrimi i Hungarisë në lidhje me këtë
Marrëveshje sipas anëtarësimit të saj
në Bashkimin Evropian**

Kjo Marrëveshje në asnjë mënyrë nuk duhet të dëmtojë detyrimet e Hungarisë si një shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Si pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk duhen interpretuar në mënyra që shfuqizojnë apo ndikojnë në detyrimet e Hungarisë, të vendosura nga traktatet mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian.

Neni 47

Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje

Kjo Marrëveshje duhet të konfirmohet. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të katërt nga njoftimi i fundit.

Neni 48

**Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kësaj
Marrëveshjeje**

1. Palët Kontraktuese e konkludojnë këtë Marrëveshje për një periudhë të pakufizuar kohe. Të dyja Palët Kontraktuese do të kenë të drejtën ta prishin këtë Marrëveshje në fund të çdo viti kalendarik, duke njoftuar me shkrim përmes kanaleve diplomatike, tre muaj përpara.

2. Nëse kjo Marrëveshje bëhet e pavlefshme për shkak të prishjes, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohen në lidhje me të drejtat e fituara dhe përfitimet e fituara deri në datën e përfundimit. Dispozitat kufizuese mbi përjashtimin e ndonjë kërkesë, për arsye të qëndrimit jashtë shtetit, apo mbi pezullimin apo tërheqjen e përfitimeve nuk do të merren parasysh për këto kërkesa, nëse vendi i qëndrimit i personit të interesuar është në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar sipas ligjit të Palëve këtu duhet të firmosin këtë Marrëveshje dhe të vendosin vulat e tyre.

Bërë në Tiranë, më 10 dhjetor 2014, në dy kopje në gjuhët shqipe, hungareze dhe angleze, ku secili tekst është njëllëj autentik. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

SHTOJÇË

PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizatat ndërlidhëse

Bazuar në paragrafit 1, të nenit 30, të kësaj Marrëveshjeje, organizatat e përcaktuara si ndërlidhëse janë si më poshtë:

për Hungarinë:

a) lidhur me kapitullin 3, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje (pensionet), organi i sigurimit të pensionit të detyrueshëm;

b) lidhur me kapitullin 4, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje, organi social dhe i rehabilitimit, dhe

c) lidhur me rastet e tjera, organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm;

për Republikën e Shqipërisë:

a) lidhur me pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar, përfitimet në para për sëmundje, barrëllindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, organi i sigurimit shoqëror të detyrueshëm;



b) lidhur me përfitimet në natyrë, organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm.

2. Institucionet kompetente

Në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje, institucionet kompetente do të jenë:

në Republikën e Shqipërisë:

a) në lidhje me pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar, përfitimet në para për sëmundje, barrë lindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, organi i sigurimit shoqëror të detyrueshëm,

b) në lidhje me përfitimet në natyrë, organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm;

në Hungari:

a) në lidhje me pjesën II, kapitujt 1 dhe 2, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje, organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm dhe organet e sigurimit shëndetësor në kryeqytet dhe në zyrat e qeverisjes së qarkut;

b) lidhur me pensionet dhe pensionet vjetore për aksidente, të parashikuara sipas kapitullit 2, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me pensionet sipas kapitullit 3, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje, organi i sigurimit të pensionit të detyrueshëm dhe organi qendror i sigurimit të pensionit;

c) lidhur me kapitullin 4, të pjesës III, të kësaj Marrëveshjeje, organi social dhe i rehabilitimit dhe organet e rehabilitimit në kryeqytet dhe në zyrat e qeverisjes së qarkut.

PJESA II DISPOZITAT PËR PËRFTITIMET

KAPITULLI 1 SËMUNDJA DHE BARRËLINDJA

3. Bashkimi i periudhave të sigurimit

3.1 Për të përfituar nga dispozitat e nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, personit të interesuar i kërkohet t'i dorëzojë institucionit kompetent një certifikatë ku tregohen periudhat e plotësuara të sigurimit, e cila lëshohet nga ajo Palë Kontraktuese në legjislacionin e të cilit i nënshtrohej më parë personi i interesuar.

Certifikata duhet të lëshohet me kërkesë të personit të interesuar:

në Republikën e Shqipërisë, nga organi i sigurimit shoqëror të detyrueshëm;

në Hungari, nga organi i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm dhe organet e sigurimit shëndetësor

në kryeqytet dhe në zyrat e qeverisjes së qarkut;

3.2 Nëse personi i interesuar nuk dorëzon certifikatën, institucioni kompetent do të kontaktojë institucionin kompetent apo organizatën ndërlidhëse në rast se institucioni kompetent është i panjohur, të Palës Kontraktuese sipas legjislacionit të së cilës personi i interesuar ka të drejtën të marrë këtë certifikatë.

3.3 Çdo person i siguruar, i cili ka marrë përfitime në natyrë, pa përmbushur kriteret e parashtruara në paragrafin “a”, të nenit 15, të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë të drejtën për t'u rimbursuar nga institucioni kompetent duke dorëzuar dokumentet mbështetëse përkatëse në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese që institucioni kompetent zbaton.

4. Rimbursimi midis institucioneve

4.1 Rimbursimi i përfitimeve në natyrë të dhëna nga institucioni i vendit të qëndrimit sipas nenit 15 të Marrëveshjes do të bëhet nga institucioni kompetent mbi bazën e shpenzimeve reale, duke marrë parasysh dokumentet mbështetëse të dorëzuara.

4.2 Rimbursimi të cilit i referohet pika 4.1 e kësaj shtojce duhet të paguhet në çdo vit kalendarik, brenda dymbëdhjetë muajve pas paraqitjes së kërkesave.

KAPITULLI 2 AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

5. Përfitimet në para në rast të qëndrimit apo banimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese

5.1 Në mënyrë që të tërheqë përfitimet në para, sipas paragrafit 2, të nenit 20 dhe nenit 21, të Marrëveshjes, personi i interesuar, brenda një kohe të arsyeshme dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, duhet të njoftojë për paaftësinë e tij/saj për punë institucionin e vendit të qëndrimit apo banimit, duke dorëzuar një certifikatë paaftësie për punë lëshuar në përputhje me legjislacionin kombëtar.

5.2 Me kërkesë të institucionit kompetent, institucioni i vendit të qëndrimit apo banesës duhet më pas të kryejë të gjitha kontrollet e nevojshme administrative apo vizitat mjekësore të personit të interesuar sikur ai të ishte i siguruar me atë institucion dhe duhet rezultatet t'ia njoftojë institucionit kompetent. Institucioni kompetent ruan të drejtën që të ekzaminojë personin e



interesuar sipas legjislacionit të tij kombëtar, me shpenzimet e tij.

5.3 Sapo institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit të përcaktojë se personi i interesuar mund të rifillojë punën, ai duhet menjëherë të njoftojë këtë person dhe institucionin kompetent, duke deklaruar edhe datën në të cilën ka marrë fund paaftësia për punë e personit. Pa cenuar dispozitat e pikës 5.5 të kësaj shtojce, njoftimi i personit të interesuar duhet të trajtohet si një vendim i marrë në emër të institucionit kompetent.

5.4 Nëse vetë institucioni kompetent vendos se personi i interesuar mund të rifillojë punën, ai duhet të njoftojë këtë person për vendimin e tij dhe në të njëjtën kohë, duhet të dërgojë një kopje të këtij vendimi tek institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit. Nëse, në këtë rast, për përfundimin e paaftësisë në punë, përcaktohen respektivisht dy data nga institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit dhe institucioni kompetent, do të mbizotërojë data e përcaktuar nga institucioni kompetent.

5.5 Nëse institucioni kompetent vendos të ndalojë përfitimet në para për shkak se personi i interesuar nuk ka përmbushur rregullat e kontrollit, ai duhet të njoftojë personin për vendimin e tij, dhe në të njëjtën kohë duhet të dërgojë një kopje të vendimit të tij tek institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit.

5.6 Kur personi i interesuar rifillon punën, ai duhet të njoftojë institucionin kompetent kur ky njoftim kërkohet nga legjislacioni që ai institucion administron.

5.7 Në rast të transferimit të vendit të banimit të personit me kushte për përfitime në para, sipas neneve 20 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje, kontrolli administrativ dhe mjekësor kryhet nga institucioni i vendit të banimit me kërkesë të institucionit kompetent.

6. Përcaktimi i shkallës së paaftësisë për punë, në rast të një aksidenti në punë apo sëmundjeje profesionale që ka ndodhur më parë.

6.1 Institucionet kompetente mund të kontaktojnë njëri-tjetrin për të marrë informacione që ata i mendojnë të nevojshme për të përcaktuar shkallën e paaftësisë për punë, për të dhënë të drejtat për përfitime dhe për të vendosur shumën e përfitimeve në rastet të cilave u referohen nenet 20 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje.

7. Përkeqësimi i një sëmundjeje profesionale

7.1 Në rastin e referuar në paragrafin 2, të nenit 21, të kësaj Marrëveshjeje, personit të interesuar i kërkohet që t'i dorëzojë institucionit kompetent të Palës Kontraktuese nga e cila personi pretendon të marrë të drejtën për përfitime, të gjitha informacionet mbi përfitimet e dhëna më parë për sëmundjen profesionale.

KAPITULLI 3

PLEQËRIA, HUMBJA E MBAJTËSIT TË FAMILJES DHE INVALIDITETIN

8. Shqyrtimi i kërkesave për pensione dhe përfitime të tjera

8.1 Kërkuesi duhet t'i dorëzojë kërkesën e tij për përfitime, sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, institucionit kompetent të shtetit të banimit ose drejtpërdrejt institucionit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

Kërkesa e dorëzuar tek institucioni kompetent i shtetit të banimit duhet të dorëzohet në përputhje me procedurat e vendosura nga legjislacioni i këtij shteti. Nëse kërkesa dorëzohet drejtpërdrejt tek institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese, ky dorëzim duhet të bëhet në përputhje me procedurat e vendosura nga legjislacioni i Palës tjetër Kontraktuese.

a) Nëse kërkesa dorëzohet në Republikën e Shqipërisë, institucioni kompetent i vendit të banimit, duke përdorur formularët e përshtatshëm, duhet ta dërgojë menjëherë këtë kërkesë tek organizata ndërlidhëse hungareze.

b) Nëse kërkesa dorëzohet në Hungari, institucioni kompetent i vendit të banimit, duke përdorur formularët e përshtatshëm, duhet ta dërgojë menjëherë këtë kërkesë tek organizata ndërlidhëse shqiptare.

c) Nëse vendi i banimit është Republika e Shqipërisë, institucioni kompetent shqiptar, kur dërgon kërkesën duhet të njoftojë organizatën ndërlidhëse hungareze nëse ai është apo jo dakord për pagesën e direkte të prapambetjeve në favor të kërkuesit.

d) Nëse vendi i banimit është Hungaria, institucioni kompetent hungarez, kur dërgon kërkesën duhet të njoftojë organizatën ndërlidhëse të Republikës së Shqipërisë nëse ai është apo jo dakord për pagesën e direkte të prapambetjeve në favor të kërkuesit.



8.2 Të dhënat personale në lidhje me kërkuesin, siç kërkohet nga formulari i aplikimit, duhet të jenë të vërtetuara rregullisht nga institucioni në të cilin është dorëzuar kërkesa, i cili duhet të konfirmojë se të dhënat janë të verifikuara sipas dokumenteve origjinale.

8.3 a) Secili nga institucionet kompetente duhet të përcaktojë të drejtën e kërkuesit dhe duhet të njoftojë për vendimin e tij organizatën ndërlidhëse të Palës tjetër Kontraktuese dhe t'i dërgojë kërkuesit një kopje të këtij vendimi. Periudhat e lejuara për apelime fillojnë nga data që kërkuesi merr vendimin.

b) Ky institucion kompetent duhet të komunikojë shumën që ai pretendon t'i kthehet si kompensim për shumat e prapambetura të përfitimit.

8.4 Kur organizata ndërlidhëse ose institucioni kompetent i Palës Kontraktuese të vendit të banimit ka dijeni se një përfitues i pensioneve të pleqërisë, invaliditetit, familjar apo përfitimeve të tjera të Palës tjetër Kontraktuese, nuk ka ndaluar plotësisht të gjitha aktivitetet profesionale apo ka rifilluar këto aktivitete, ai duhet të informojë menjëherë organizatën ndërlidhëse të Palës së fundit Kontraktuese.

8.5 Organizata ndërlidhëse ose institucioni kompetent i Palës Kontraktuese ku banon një përfitues i pensioneve të invaliditetit, pleqërisë, familjar apo të përfitimeve të tjera i Palës tjetër Kontraktuese, duhet të informojë organizatën ndërlidhëse të Palës së fundit, në rast të vdekjes të këtij përfituesi.

PJESA III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR KAPITUJT 1 DHE 3 TË PJESËS III TË KËSAJ MARRËVESHJEJE NË LIDHJE ME KONTROLLIN ADMINISTRATIV DHE MJEKËSOR

9. Ekzaminimet/kontrollet mjekësore dhe kontrolli administrativ

9.1 Organizata ndërlidhëse e një Pale Kontraktuese duhet t'i sigurojë, sipas kërkesës dhe pa kosto, organizatës ndërlidhëse të Palës tjetër Kontraktuese informacionin dhe dokumentacionin mjekësor që ajo zotëron në lidhje me paafhtësinë për punë të një kërkuesi apo përfituesi.

9.2 Me marrjen e një deklarate të detajuar për koston, organizata ndërlidhëse e Palës së parë

Kontraktuese duhet që pa asnjë vonesë, të rimbursojë organizatën ndërlidhëse të Palës tjetër Kontraktuese për shumat si rezultat i zbatimit të paragrafit 2, të nenit 35, të kësaj Marrëveshjeje.

LIGJ

Nr. 153/2015

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTEVE NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM NOTASH, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES, DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “FUQIZIMI I QENDRËS TRAUMATOLOGJIKE KOMBËTARE TË TIRANËS”, NËNSHKRUAR MË 12.7.2006

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen dokumentet ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, nënshkruar më 12.7.2006, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9385, datë 6.1.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



AMBASADA E ITALISË
TIRANË

Tiranë, më 21.5.2015
Prot. 2528

NOTË VERBALE

Ambasada Italiane në Tiranë i paraqet komplimentat e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë dhe në emër të Qeverisë Italiane ka nderin t'i referohet shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë prot. 408/1, e datës 15 dhjetor 2014, me anë të së cilës propozohet ndryshimi i Shtojcës 2 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të Përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” firmosur më 13 korrik 2006.

Ambasada Italiane në Tiranë ka nderin të komunikojë që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar ka pranuar, në emër të Qeverisë Italiane, të ndryshojë Marrëveshjen e sipërcituar, në bazë të nenit 14 të së njëjtës, siç specifikohet më poshtë:

“Emërtimi “*Ministria e Punëve të Jashtme*” zëvendësohet me “*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar*”.

Shkurtimi “MAE” zëvendësohet me shkurtimin “MAECP”.

Shtojca 2- Kontratë shërbimi, furnizimi dhe punësh (Kushtet e Veçanta)

Fraza e paragrafit të dytë: “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kostot lokale dhe/ose vendeve në zhvillim, nuk mund të kaloj 40 % të kredisë*” zëvendësohet me frazën “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kostot lokale dhe/ose vendeve OCSE, nuk mund të kaloj 60 % të kredisë*”.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord me propozimet e mësipërme, kjo Notë Verbale dhe Nota Verbale e përgjigjes e të njëjtit standard do të përbëjnë një Marrëveshje mes dy qeverive tona që do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të dytë nga 2 njoftimet e parashikuara me të cilat Palët Nënshkruese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave kombëtare të ratifikimit të parashikuara sipas nevojës.

Ambasada Italiane në Tiranë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

(vulë dhe firmë)

AMBASADA E ITALISË
TIRANË

NOTË VERBALE

Ambasada Italiane në Tiranë, i paraqet komplimentat e saj Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë dhe duke iu referuar Marrëveshjes ndërqeveritare lidhur me programin “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*”, nënshkruar më 13.7.2006, ka kënaqësinë të komunikojë miratimin e saj për shtyrjen e afatit të Marrëveshjes deri më 31 dhjetor 2015 dhe për kalimin e rolit të kontraktuesit të Marrëveshjes dypalëshe të Programit për palën shqiptare nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë, në vijim të kalimit të përgjegjësisë së administrimit të Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës nga dikasteri i parë te dikasteri i dytë të lartpërmendur.

Në përputhje me sa është parashikuar në nenin 15 të Marrëveshjes së sipërcituar, ndryshimet e sipërpërmendura do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së Notës Verbale të Autoriteteve Shqiptare me anë të së cilës këto të fundit konfirmojnë vullnetin për shtyrjen e afatit të marrëveshjes deri në datën e sipërcituar dhe për kalimin e rolit të kontraktuesit të kësaj Marrëveshje për palën shqiptare nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë.

Ambasada Italiane në Tiranë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

(vulë dhe firmë)

Ministrisë së Shëndetësisë
Ministrisë së Financave
Ministrisë së Punëve të Jashtme
Këshilli të Ministrave-Departamenti i Zhvillimit,
Programimit, Financimit
dhe Ndhmës së Huaj
Tiranë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi lekë